



Të pikëlluar e të përcarë

Në këtë frymë ka kaluar përkujtimi i një vjetorit të vdekjes së presidentit të ndërë, Ibrahim Rugova. Rugova është nderuar me urdhrin "Heroi i Kosovës". Pasuesit e tij, edhe ditën e homazheve e kanë shfrytëzuar për pakëz propagandë politike.



SURROI I SIGURT

Policia i heq sigurimin Veton Surroit. Ata arsyetohen se nuk ka më rrezik për të. Por, zyrtarët nuk kanë treguar nëse kanë arrestuar dikë në lidhje me shpërthimin i cili pati demoluar tërësisht zyrën e kësaj partie.

f10

Express

www.gazetaexpress.com

N° 685, Viti III, Çmimi: 0.20 € • E përditshme e pavarur kosovare

E hënë

22 janar, 2007



Fiks tri arrestime

Agim Bytyqi, Kadri Sylejmani dhe Nasid Nuhi janë personat që ka arrestuar policia me akuzën për korrupsion. Arrestimi i tyre është bërë i mundur pas xhirimeve të fshehta të emisionit Fiks Fare të televizionit Top Channel nga Shqipëria.

NUK NDRYSHOJNE

SERBËT

Rezultatet preliminare

- SRS - 28,5 %;
- DS - 22,9 %;
- DSS-NS - 17 %;
- G17 plus - 6,8 %;
- SPS - 6,1 %;
- LDP - 5 %.

f6-7

Edhe pas vdekjes së Millosheviqit, votuesit serbë mes radikalëve ekstremë nacionalistë dhe një shtresë të partive pro-reformiste, më së shumti i kanë besuar Partisë Radikale Serbe, të kriminelit të luftës Vojislav Sheshel. Këtë e tregojnë rezultatet preliminare të zgjedhjeve serbe.

WESTERN UNION
TRANSFERTE PARASH
Per çdo informacion: www.ufp-ks.com;
Tel: +381 38 549 840; Mob: +377 44 110 840

SIGURIA
KOMPANIA E SIGURIMEVE
INSURANCE COMPANY
In Llozë Prishtinë, Kosovë. Qendër: Tel: +381 38 248 840; 248 840; 248 840; 248 840

dukagjini
Korporata e sigurimeve
Insurance company
www.dukagjini.com; Tel&Fax: 038 543 575; 576

SIGKOS
KOMPANIA E SIGURIMEVE
INSURANCE COMPANY
LESNANEC
www.sigkos.com
Tel: +381 (0)38 24 80 22; Fax: +381 (0)38 24 82 22

Pressing



DREJTOR: Baton Haxhiu baton.haxhiu@gazetaexpress.com, KRYEREDAKTOR: Berat Buzhala berat.buzhala@gazetaexpress.com, NDIHMËSKRYEREDAKTOR DHE POLITIKË: Valon A. Sylva valon.sylva@gazetaexpress.com, NACIONALIA DHE DHE SIGURI: Ilir Mirena ilir.mirena@gazetaexpress.com, EKONOMI: Viktor Buzhala viktor.buzhala@gazetaexpress.com, BOTA SOT: Faton Raçi faton.raci@gazetaexpress.com, SPORT: Afrim Toverlani afrim.toverlani@gazetaexpress.com
FOTOGRAFIA: Astrit Ibrahimit astrit.ibrahimi@gazetaexpress.com, DREJTOR I MARKETINGUT: Vjolla Musa, marketing@gazetaexpress.com;
REDAKSIA: info@gazetaexpress.com; TEL: 038 542 270, 038 542 271, 038 542 272, 038 542 273, 038 542 274; FAX: 038 542 275; SHTYPI: NM; BOTUES: MediaWorks.

E hënë, 22 janar 2007

PRESSING

Një ditë pas / **Baton Haxhiu**2

LAJMEXPRESS

Perkujtim / **Leonard Kerçuki**3,5

POLITIKE

Zgjedhje treguese7

NACIONALE

Fiks tri arrestime / **Jeton Musliu**9

Surroi i sigurt / **Artan Behrami**10

Bashkim i përkohshëm / **Bardh Frangu**11

Martohet me djalin e saj11

Plumba për vëllain? / **Jeton Musliu**12

Parajsë piratësh12-13

EKONOMI

Rrjeti i askujt

/ **Jasmin Rexhepi**14-15

BOTA

Clinton e preferuar18

Formulat e e-mail -it18-19

Identifikohet vrasësi i Litvinenkos19

Turqia e tronditur20

ARTE

Arti nuk është pasqyre / **Alban Muja**21

Kukumi në Amerikë / **Milot Hasimja**21

Rugova i letërsisë / **Alfred Beka**22

Vdiq Paul! Rrofte Paul!22-23

E pakënaqura Patti Smith24

Stallone ekranizon gjencidin armen?24

SPORT

I gatshëm për Kombetare28-29

Bariç "tradhtohet" nga klubet29

Kryesojnë ekipet e kryeqytetit29

Rikthimi është fitore30

Një ditë pas

Serbët duhet të përcaktohen qartë, o për liderë të zhytur në nacionalizëm dhe gjak o në ndihmë ekonomike perëndimore. Nuk mund t'i kenë të dyja. Prej sot nuk është më fushatë. Është jetë reale që don çlirimin definitiv të Kosovës nga iluzioni serb dhe kthimit të saj në Kosovë.



Baton Haxhiu

Zgjedhjet serbe kanë përfunduar. Prej, sot, nuk ka më as shtyrje as falje dhe as arsye që të dëgohen pallavrata. Të dëgohen vlerat dhe ikonat historike.

Serbët, Kosovën, prej sot nuk guxojnë ta konsiderojnë më qendër të veten historike - "djep" të kaluarës së tyre. Shihet qartë se ishte ide e fryrë, ide politike. Kjo formë e të kuptuarit të Kosovës, edhe gjatë këtyre zgjedhjeve, e krenuar dhe e përkujtuar në folklor, së fundi, po mbetet traumë kryesore në kujtesën e serbëve të Kosovës.

Ideja e djepit serb gjatë zgjedhjeve ishte zëvendësuar, mjeshtërisht, me idenë e viktimës që serbët po e përjetojnë pas vitit 1999.

Në këtë mënyrë serbët dhe politika e saj po mundohen t'i vënë pikë debatit për krimet që kanë bërë duke e shndërruar situatën në të tanishmen dhe duke viktimizuar të tërën serbe në Kosovë.

Por, debatit mbi krimet e kryera në emër të serbëve nuk duhet vënë pikë. Tregimi për pastrimin e mëkateve aq lehtë dhe krejtësisht i natyrës politike dhe të presionit po duket shumë i shëmtuar.

Serbët e Kosovës janë dhe vazhdojnë të jenë viktimat. Ose të quhen si të tillë. Ata janë viktimat, vërtet, por janë viktimat të përkrahjes së një politike të tyre dhënë për, apo pajtimit me, luftën e Milosheviqit dhe radikalëve. Dhe këtë e vazhdojnë përsëri nëpërmjet Koshtunicës dhe radikalëve.

Por çka do të bëjnë pas ditës së sotme. Të vazhdojnë lojën e viktimës apo të hyrjes në jetën politike në Kosovë. E kuptojmë fushatën dhe ekzaltimin nationalist. Kuptojmë fyerjet dhe thyerjet. Por nuk e kuptojmë se deri ku. Nuk po e kuptojmë pse nuk përfundojnë me iluzionin dhe dëshirën që ta kthejnë Serbinë në Kosovë.

Kësaj hataje politike dhe lojës së tillë bashkësisë ndërkombëtare po e përkëdhel duke e bërë të frymojë si problem e jo si fund të lojës.

Edhe pas intervenimit ndërkombëtar problemi i Kosovës është ekzistues dhe është këtu. Gati i njëjtë. Zgjidhja e saj nuk do duhet të jetë mjaft larg. Sa më shumë të shtyhet, aq më i madh do të jetë rreziku nga konfrontimet që lehtë mund të përhapet përtej kufijve të Kosovës. Njyt edhe tensionet etnike në Kosovë janë të lidhura me plagët e pasluftës: Ripërtëritja e dhunës në Kosovë mund të ketë reperkusione të dhunës jashtë Kosovës. Mbi këto preokupime tona, po deshët mund t'i quajmë edhe strategjike, ngrihet edhe një detyrim moral, ngase gjendja e shqiptarëve të Kosovës është gjendje e një populli i cili konsideron se trajtohet "sikur i huaji në vend të vetin." Është peng e pezullit gjeostrategjik. Dhe pengë e pafuqisë së bashkësisë ndërkombëtare ta heq nacionalizmin dhe politikën e njëjtë nga pushteti për shkak të përkrahjes që ky mentalitet ka në Serbi. Nga kjo pamundësi topi hedhet te shqiptarët.

Për shmangien nga një dhune dhe avancimin e një procesi politik nevojitet procesi urgjent i vendosjes së statusit i cili do saktësuar dhe se pavarësia e Kosovës do të ishte e pashmangshme.

Prandaj, për Kosovën dhe statusin e saj duhet një shtyrje të fuqishme dhe me një ndërmjetësim të dhe përfundim të sigurtë e afatgjatë nga Perëndimi. Por gjithsesi nuk duhet një përkëdhelje e tepruar për serbët, të cilët, përkëdheljen ndërkombëtare po e shndërrojnë në propagandë kundër tyre për ta rrëzuar procesin e paqes në Kosovë.

Nuk duhet që bashkësia ndërkombëtare të mbajë peshën e fajësisë për shkak të intervenimit në Kosovë. Tek e fundit, për shumë kë, intervenimi në Kosovë është intervenimi më human që është bërë ndonjë herë në historinë e saj.

Dikujt i duket e tepërt për të kujtuar gjithë këtë në këtë kohë. Por po shihet që po fillohet t'i vihet një barazim të kaluarës dhe të tashmes. Të barazohet krimi. Të barazohet e kaluara.

Fushata dhe barazimi i krimit në Kosovë për të sjellë shqiptarët e Kosovës në nënshtrim, do të sjellë dështimin dhe konsekuencat për bashkësinë ndërkombëtare. Sepse shqiptarët e Kosovës po presin një ringritje morale dhe ekonomike duke ikur nga të qenit peng të situatave shpërblyese për Serbinë e cila po pretendon të bind të gjithë se ka harruar atë që ka ndodh para vitit 1999. Dhe se fajin dëshirojnë ta hedhin mbi individin. Këtë e thane edhe gjatë fushatës duke e lënë Millosheviqin fajtorë dhe duke supozuar se ata do të jenë demokratë e procesit.

Duhet thënë se serbët si individë mund të jenë të pafajshëm. Por tentimi i vrasjes së Kosovës është bërë me vullnet nga serbët si akt kombëtar. E institucionalizuar dhe e implementuar nga liderët e tyre kombëtarë, të cilët ende janë në pushtet dhe përkrahen për të mbetur në pushtet.

E tashit, nuk ka dyshim, se pas një agresioni rrenash të këtyre ditëve. Thuhet se janë gjatë fushatës dhe nuk iu shihet për të madhe. Edhe ndoshta, por...

Fuqitë perëndimore, duhet bashkërisht të kuptojnë depozitin ndërkombëtar për rajonin, njëherësh të kenë një ide më të qartë se forma përfundimtare e një zgjidhjeje duhet të përshkruhet në mënyrë eksplicite. Status quo-ja nuk mund - nuk do të duhet - të vazhdonte. Së pari duhet që të thyhet iluzioni serb për kthimin e forcave serbe në Kosovë. Ndryshe tensioni dhe e ardhmja e pasigurt për këtë vend do të vazhdojë. Bashkë me të do të vazhdojë edhe ideja e luftës dhe konfliktit dhe dështilimit në Ballkan.

Serbët nuk duhet të lihen që të vuajnë në vetmi dhe të mllafosen edhe më tej. Por kontakti të cilin Perëndimi ka me ta tashit duhet të bazohet në ndryshime, jo në rekonstruktiv që do t'i ndihmonte ata në ikjen nga konsekuencat e dhimbshme të së keqes së tyre. Ata mund të kenë liderë të zhytur në nacionalizëm që kanë bërë gjak, ose mund të kenë ndihmën perëndimore për ekonomi dhe koekzistencë me të tjerët. Nuk mund t'i kenë të dyja.

PERKUJTIM



FOTO: ASTRIT IBRAHIMI

Në një vjetorin e vdekjes, Ibrahim Rugova shpallet Hero i Kosovës. Qytetarët sërish derdhin lot tek varri i tij. Cilësohet si lideri më i madh i Kosovës, si faktor paqeje e uniteti.

Leonard Kerquki

leonard.kerquki@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 21 JANAR — Në orët e mbrëmjes të dyja anët e sheshit kryesor të Prishtinës janë mbushur me qirinj, ndërkaq flamujt në tërë territorin e vendit janë ngritur në gjysmë shtizë, në nderim të liderit shtatëmbëdhjetëvjeçarë të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugovës, i cili ndërroi jetë një vit më parë.

Në përvjetorin e parë të vdekjes së liderit historik, përfaqësues institucionesh, partish politike e diplomat ndërkombëtarë kanë dërguar lule dhe janë përkulur para varrit të tij. Ngjashëm kanë vepruar edhe qindra qytetarë, të cilët të dielën ia kishin mërsyer varrit të Rugovës në lagjen Vela-

nia.

Pak metra më larg, edhe shtëpia ku banonte ish-presidentit i kishte hapur dyert për të pritur delegacione të ndryshme, të cilat shkonin për ta ngushëlluar familjen e ngushtë të Ibrahim Rugovës.

I gjithë aktiviteti për përkujtimin e jetës dhe veprës së Ibrahim Rugovës në njëvjetorin e vdekjes është organizuar nën patronatin e presidentit aktual Fatmir Sejdiut. Ceremonia kryesore, ndërkaq, ka qenë një akademi përkujtimore në Teatrin Kombëtarë ku kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjitha partive politike në Kosovës dhe shefat e zyrave ndërkombëtare në Prishtinë.

Në këtë akademi, në prani të familjes së ngushtë të Ibrahim Rugovës, presidenti Sejdiu, Rugovës

i ka dhënë urdhrin Hero i Kosovës dhe ka themeluar një medalje me emrin e tij që do t'u jepet personaliteteve të huaja që i kontribuojnë paqes, demokracisë dhe humanizimit. Tri virtyte këto, që thuhet se e kanë përshkruar jetën e Rugovës, që nga viti 1989 kur filloi rezistencën paqësore kundër regjimit të Millosheviqit dhe me ç'rast hodhi bazat e demokracisë në Kosovë, gjithnjë duke ndjekur një politik paqësore.

Një vit më parë, me 21 janar të vitit 2006 në orën 11:35 presidenti Ibrahim Rugova në duart e një ekipi mjekësh amerikan kishte lëshuar frymën e fundit, duke u dorëzuar kështu para sëmundjes së kancerit në mushkri. Bota kishte kthyer sytë nga Kosova duke iu bërë thirrje liderëve kosovarë për

unitet në prag të zgjidhjes së statusit final. Këto thirrje duket se ishte marrë seriozisht nga përfaqësuesit e të gjitha partive politike, atyre të pozitës dhe opozitës, përveç partisë që udhëhoqi Rugova për 17 vjet, Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Disa muaj pas vdekjes së tij, LDK-ja u përça në dy taborre, në atë të Fatmir Sejdiut dhe Nexhat Dacit. Madje as përvjetori i parë i vdekjes nuk ka mundur t'i bëjë bashkë. Kryetari i ri i LDK-së dhe njëherësh presidenti i vendit Fatmir Sejdiu nuk e ftoi Nexhat Dacin dhe njerëzit e tij të tubuar rreth LD-së në manifestimet për nder të vdekjes së Rugovës, ndërkaq teksa bënte homazhe tek varri i ish-presidentit, Nexhat Daci gjua-jti akuza në adresë të ish-kolegëve të tij të partisë. Ndërkaq në akademinë përkujtimore Daci shkoi i pafuar dhe mbeti disa çaste në këmbë. Sejdiu s'i kishte rezervuar atij ndonjë karrige.

VAZHDON NË FAQË 5

RUGOVA, HERO I KOSOVËS



Presidenti Fatmir Sejdiu e ka dekoruar presidentin e parë të Kosovës Ibrahim Rugovën

në njëvjetorin e vdekjes së tij me urdhrin Hero i Kosovës. Ndërkaq, duke i mbështetur në Kornizën Kushtetuese, Sejdiu ka themeluar "Medaljen për Paqe, Demokraci dhe Humanizëm - Ibrahim Rugova". Kjo medalje, siç tha presidenti Sejdiu, do t'u jepet personaliteteve të huaja që do të kontribuojnë për paqen, demokracinë dhe humanizmin.

shkurteshqip

shkurt e shqip Arben Idrizi, e-mail: shkurteshqip@gazetaexpress.com
TEL: 038 542 270 ADRESA: Dardania 1/1, Prishtinë

"Ne kemi nevojë për kënaqësi maksimale në Kosovë, por gjithashtu për kënaqësi, ose së paku jo trazira, në Serbi".

Angela Merkel, Kancelare e Gjermanisë

Paradigma epistemologjike e racionalizmit politik evropian

Gazmend Islami

Epistemologjia është teoria filozofike e njohjes shkencore. Ajo tenton të reflektojë sa përputhet hulumtimi i teorive shkencore me realitetin, nëse ekziston apo jo njohje objektive e realitetit dhe çfarë mjetesh duhen ndjekur për të dhënë rezultate sa më të sakta...

Në dallim me matematikën, fizikën, biologjinë, "shkencat e shpirtit" dhe në veçanti shkencat që kanë të bëjnë me shoqërinë nuk mund të arrijnë në rezultate të sakta verifikuese, sepse realiteti shoqëror është shumë kompleks dhe nuk ekziston një zgjidhje përgjithësisht e vlefshme, ashtu siç kërkoi në fillim pozitivizmi i Auguste Comte apo variantet e tij më moderne, siç është racionalizmi politik. Ky orientim shkencor modern beson "në argumentimet teknike dhe mënyrat e veprimit të racionit [...] Cilësia që racioni e merr parasysh për vetën është ajo e inxhinierit, një inxhinier të cilit shpirti i ndodhet në mënyrë të përhershme nën kontrollin e teknikës së përshtatshme" (Okënsht). Politika që bazohet në këtë lloj mendimi epistemologjik është politikë e përkryerjes dhe uniformitetit. Çfarë nuk mund ajo të kuptojë është se, teknika nuk mund të jetë adekuat me realitetin, se nuk ka një zgjidhje unike universale për çdo tip problemi. Rrethanat specifike duhen marrë në konsideratë. Në rast të kundërt, "teknika" lind përbindësia utopikë që hanë jeta të shumta njerëzore, shkatërojnë shoqërinë globale apo harmoninë politike ndërkombëtare. Pikërisht mendimi politik aktual evropian gjendet bukur shumë kohë në një kurth të tillë. Dallojmë dy mënyra të gabueshme veprimi në mbarëvajtjen (menaxhimin) e situatës në Ballkan:

1) trajtimi sipas politikës së "ekuilibrit të forcave" të rajonit, pa marrë parasysh realitetin historik dhe politik, specifika të tij. Kjo ka shkaktuar tragjedinë e "ligjërim-it" të pushtimit dhe kolonizimit sllavo-grek mbi trojet dhe popullin shqiptar me anë të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës. Dhënia e Kosovës historike, Serbisë dhe Çamërinë Greqisë, ka paraqitur për momentin një "zgjidhje kompromisi" midis blloqeve të kundërta evropiane (blloku gjermano-austriak dhe blloku france-

zo-rus). Ata nuk kanë marrë parasysh të drejtat legjitime të popullit shqiptar dhe vendimin mbarëkombëtar të Kuvendit të Vlorës.

Si në të kaluarën, edhe sot, i njëjti ekuilibër i forcave po funksionon kur vjen fjala për "përcaktimin e statusit të Kosovës". Mendimi politik evropian dëshiron të "mbajë status kuon e rajonit": Kosova të këtë "sovrانيتet të kushtëzuara" (ashtu siç pohan një raport i fundit i Këshillit Evropian, siç raporton RTK-ja), gjë që nënkupton "më shumë autonomi, më pak pavarësi", nën pushtimin dhe kolonizimin e Serbisë, një republikë boshnjake brenda saj dhe zëvendësimin e UNMIK-ut me EUMIK.

Kufijtë në Ballkan është dashur nga Evropa të ndryshohen vetëm në të mirën e putrave ekspansioniste të ariut rus apo të dhelprës serbe, kurse kur është fjala për ribashkimin e Shqipërisë, ata gjejnë miliona "arsye" përse "nuk duhet" apo "nuk kemi leje". Këto "gabime" nuk janë të pa qëllimshme, siç nuk është i rastësishëm bashkimi i dy Gjermanive apo krijimi i Malit të Zi.

Të gjitha shtetet pjesëmarrëse në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore nuk kanë pësuar ndryshime shumë të mëdha, siç ka pësuar Shqipëria Etnike në ato kohëra. E pse vallë kjo të ndodhë mu me një shtet i cili as më pak as më shumë, nuk ka kërkuar të pushtojë treva të huaja, por vetëm është mbrojtur? Pse kancerit të Ballkanit (projektit utopik sllavo-grek), i jepet përparësi dhe i jepet e drejtë të zmadhohet në dëm të tokave edhe ashtu të copëtuara të kombit tonë, ndërsa në anën tjetër kërkohet që Kosova të heshtë dhe të jetë kënaqur me atë fasadë të quajtur "pavarësi", me kokën nën Serbi. Shihet qartë se Evropa vazhdon të thellojë "gabimin" që ka bërë apo më mirë të themi qëllimin e saj, që të shkatërojë shtete që kalojnë apo i afrohen madhësisë së saj dhe i pengon që një popull i shumëvujtur si shqiptarët të lirohen dhe të ribashkohen në shtetin e tyre të dikurshëm, Shqipërinë e Bashkuar dhe brenda kufijve të saj.

2) trajtimi i rajonit sipas "teorisë së integrimi", që nënkupton krijimin e "Ballkanit Perëndimor" (bllok unik i shteteve ballkanike) dhe hyrjen më pas të tij brenda

Bashkimit Evropian. Mendimi politik evropian nuk është në gjendje të kuptojë se nëse në Evropën perëndimore konfliktet u zgjidhën me anë të integrimi, në "skajin" e saj Ballkanin, ka një situatë të ndryshme prej asaj të konflikteve etnike nga Evropa perëndimore: trojet shqiptare mbahen ende të pushtuara dhe të kolonizuara. Pra, çështja shqiptare është çështje koloniale, që ndryshon nga konflikti i dikurshëm gjermano-francez mbi Alsacinë e Lorenën. Nëse Evropa përpiket të zgjedhë problemet në të njëjtën mënyrë si "në dhomën e vetë", nëpërmjet bashkëveprim-it dhe integritit të kundërshtarëve në një sistem të përbashkët ekonomik dhe të vlerave (siç është sot Bashkimi Evropian), kjo teknikë nuk i përputhet realitetit në Ballkan. Kjo teknikë është favorizuese e planeve serbomëdha, është nxitëse e hegjemonizmit dhe ekspansionizmit të shteteve koloniale Serbia, Greqia, IRJM-ja dhe Mali i Zi që ditën deklarohen për "mirëbesim", "multietnicitet" dhe "integrim në BE, ndërsa natën kundërshtojnë në mos më keq planë për mbajtjen nën pushtim dhe kolonizim të trojeve shqiptare dhe për gëlltitjen e gjysmë shtetit shqiptar.

S'ka teori të integrimi që mund të implementohet në Ballkan pa përfundimin e çështjes koloniale shqiptare! Për situatën specifike duhet zgjidhje specifike: vetëvendosja e tërë popullit shqiptar. Kjo është në frymën e globalizmit përparimtar dhe harmonisë së marrëdhënieve ndërkombëtare

që sjellin paqe, miqësi e bashkëpunim me dobi reciproke mës popujve që dallon nga globalizmi i mafisë politike e klasike që më vete mbarë globalizmin e klaneve kriminale me jaka të bardha ndaj vendeve të varfëra, me globalizmin e hajnave, narkomanisë e të prostitucionit si dhe të dukurive të tjera negative.

Çelësi i hapjes së rrugës së zhvillimeve pozitive, për të bllokuar "inxhinierinë" e epistemologjisë politike racionaliste specifike të globalizmit dhe të dukurive kriminale, ndodhet në zgjidhjen reale të çështjes koloniale shqiptare. Dhe kjo duhet të ndodhë shumë shpejt, sepse rreziket që po na kanosen janë të mëdha.

Torbjorn Solstrom, i dërguari i Solanës, "është cituar të ketë deklaruar para gazetareve se bashkësia ndërkombëtare do të qëndrojë në Kosovë përgjithmonë, sepse Bashkimi Evropian nuk ka strategji dalëse nga Kosova, duke shtuar se do të ndërrojë vetëm natyra e pranisë ndërkombëtare do të ndryshojë. Kjo do të thotë se BE ka hequr dorë nga dërgimi i një misioni vetëm të tij dhe të pranisë ushtarake të BE-së, pasi që kanë paralajmërimet se mund të ndahen keq.

Por ata po duan të shfrytëzojnë emrin e NATO-s për të fshehur misionin e vet të invadimit dhe okupimit ushtarak të Kosovës, sikur që janë fshehur pas emrit të UNMIK-ut që shtatë vite. Ata paralajmëruan se "...forcat e NATO-s do të kalojnë nëpër Serbi për të ardhur në Kosovë...".

Prapavija e kësaj është e qartë.

NATO nuk do të duhej kurrë të vijë nëpër territorin serb, asnjëherë, sepse do të merrej në shënjestër si ushtri serbe. Para kësaj BE-ja duke e dërguar ushtrinë e vetë në emër të NATO-s nëpër Serbi, e dinë se në Kosovë do të hasë në rezistencë të armatosur dhe me këtë dëshiron të inskenojë situatën që "shqiptarët janë kundër NATO-s", që pastaj të legjitimohet dhuna ndaj shqiptarëve. BE-ja dëshiron të krijojë një situatë artificiale se Kosova është kundër NATO-s, dhe kështu të bindë edhe amerikanët se ata nuk duhet më të përkrahin shqiptarët. Pra, qëllimi përfundimtar është që të bindet SHBA-ja që të tërhiqet nga kjo pjesë e jugut të Evropës dhe pastaj Serbia, Greqia, IRJM-ja dhe Mali i Zi të vazhdojnë terrorin shtetëror dhe politikën e tyre, për asimilimin e shqiptarëve në kuadrin e "Ballkanit Perëndimor" dhe më pas të BE-së...

Kjo është "matematika" e racionalizmit politik të Evropës së kryesuar nga qarqe serbofile dhe grekofile të ndikuara (shantazuara) ekonomikisht nga Rusia! Por në raport me çështjen shqiptare, Evropa po bie çdo herë në rolin e "Çirakut Shtrigan" të Goethe-s që konsideronte se e ka më lehtë të dredhet duke bërë një ystjje se sa të mbarët ujën, kovë me kovë, deri në mbushjen e vozës që e urdhëron zotin e tij, magjistarin. Pasi tregoi ystjjen, kovat nisën të mbushin vetë vozën derisa uji i tejkalonte skajet e tij dhe çiraku vetëm atëherë kuptoi se ai nuk e di aspak formulën magjike për të bërë kovat të pushojnë nga rruga e sjelljes së ujit...



FOTO: ASTRIT IBRAHIMI



FOTOT: JETMIR IDRIZI

VAZHDON NGA FAQJA 3

Përkulja para varrit

Daja i ish-presidentit Rugova, Halit Rugova ka prekur të gjithë të pranishmit që kishin shkuar për të bërë homazhe tek varri i nipit të tij. Ai s'pushonte së qari, ndërsa pëshpëriste fjalët të mbuluara nga gjëma e vaji. "Si të la daja në varr tash një vit", thoshte ai.

Varri i presidentit Rugova është vizituar edhe nga qindra qytetarë dhe përfaqësues institucionesh. I pari ndërkaq ka mbërritur presidenti Fatmir Sejdiu, i cili tha se ka ardhur aty për të shprehur me shpirt dhe zemër përkujtimin e përhershëm për njeriun e madh të Kosovës.

Ndërkaq kryeadministratori Joakim Ruecker, i cili bëri homazhe bashkë me bashkëpunëtor, tha se është një ditë e madhe për Kosovën meqë përkujtohet vdekjen e presidentit Rugova.

Gjithashtu homazhe tek varri i liderit emblematik të shqiptarëve të Kosovës kanë bërë edhe kryetari i Kuvendit Kolë Berisha, kryeministri Agim Çeku, komandanti i KFOR-it gjenerali Roland Kather, ai TMK-së Sylejman Selimi, krye-

sia e LDK e kreu i Kuvendit Komunal të Prishtinës, Ismet Beqiri, kryetari i ASHAK Rexhep Ismajli, ish kryeministri Ramush Haradinaj e të tjerë.

Po ashtu veç nderimeve të Memorialit Rugova, delegacione të shumta vizituan edhe familjen e Presidentit Rugova në rezidencën e saj në Velani. Familja e ngushtë e presidentit është vizituar nga presidenti Fatmir Sejdiu, zëvendës kryeministri Lutfi Haziri, ish-kryeparlamentari Nexhat Daci, nga kryetari i AAK-së Ramush Haradinaj dhe shumë personalitet tjera.

Akademia për Presidentin

Përkujtimi për presidentin Ibrahim Rugova në akademinë përkujtimore në Teatrin Kombëtarë ka rikthyer dhembjen e një vit më parë, duke rikujtuar çastet e dhembjes për liderin historik.

Presidenti Sejdiu, duke iu drejtuar të pranishmëve, ka thënë se kjo akademi shërben për të përkujtuar nderimin e veçantë për personalitetin e pashembullt - presidentin historik të Kosovës. Sipas tij, 21 janari 2006 ishte goditje e rëndë për popullin dhe institucionet e Kosovës.

"Na la kur na duhej më shumti për t'i dalë në krye procesit të gjatë e të mundimshëm historik për pavarësimin e Kosovës", tha Sejdiu.

Më pas ai i bëri një vlerësim të përmblodhur figurës prej dijetari, studiuesi dhe letrari, duke thënë se Rugova la një trashëgimi në themelet e dijes sonë. Presidenti Sejdiu kujtoi se nga dijetari, Rugova u bë udhëheqës i rezistencës së popullit shqiptar të Kosovës.

"Me organizimin e pashembullt që krijoi Lidhja Demokratike e Kosovës në krye me Rugovën, si Lidhja e Prizrenit, për të cilën ai ushqente dashuri të pakundshoqe - të ndërtonte, tani me sukses të fundmit, bazat e shtetit të ri, ndërsa rezistonte okupimin serb", tha ai.

Sipas tij, Rugova me vizionin e tij politik që i buronte nga thellësia e dijes së mirëfilltë, e guxim-it qytetar u shndërrua në emblemë të lëvizjes politike të shqiptarëve, ndërsa citoi thënieën e Presidentit Rugova: "Ne deshëm t'i afrohem Perëndimit dhe nuk u mbyllem në histori".

Ndërsa, Joakim Ruecker tha se Ibrahim Rugova ka qenë forcë bashkuese dhe moderuese si dhe forcë unifikuese për Kosovën. "Ru-

gova në të njëjtën kohë ishte forcë e paqes dhe forcë e ndryshimit", tha Ruecker.

Thanë për Rugovën

Miku i tij i dikurshëm dhe tash anëtar i kryesisë së LDK-së, Sabri Hamiti tha se për te Rugova ende është i gjallë, në të gjitha kuptimet. "Është një krua i gjallë Rugova, në të gjitha kuptimet për Kosovën. Një natyrë në të njëjtën kohë e gatshme të rebelohet dhe në të njëjtën kohë që të mësojë, d.m.th. njëfarë tip kryqëzimi i Naimit dhe Fishtës, ta quajmë ne", tha Hamiti.

Ndërkaq përfaqësuesi i SHBA-ve në presidentin e bisedimeve për statusin e Kosovës, Frank Wisner është shprehur se presidenti Rugova e ka udhëhequr dhe e ka krijuar shpirtin në Kosovë, duke e sjellë vendin aty ku është sot. "Presidenti Rugova ka qenë njeri i jashtëzakonshëm", ka thënë ai.

Ndërkaq kongresisti i njohur amerikan dhe miku i Rugovës Eliot Engel, thotë se ka shumë kujtime të mira nga takimet që kam pasur me Presidentin Rugova. "Ai ka qenë lider shumë i qetë, efikas. Ai e ka ngritur në çështje pavarësinë e Kosovës", ka thënë ai.

Të ndarë përfundimisht

Me një tufë simpatizantësh dhe anëtarësh të partisë së tij në themelimin e sipër, Nexhat Daci ka dërguar lule të freskëta tek varri i Ibrahim Rugovës, tek prijësi i cili arriti t'i mbaj të gjithë bashkë në LDK sa ishte gjallë. Por jo edhe për së vdekuri, sado që gjatë muajve të fundit u thirr shumë në emrin e tij, në përpjekje për t'i bërë bashkë krahët e hasmëruar në LDK.

Përvjetori i parë i vdekjes së Rugovës vetëm se ka ridëshmuar ndarjen e partisë që udhëhoqi për 17 vjet. Udhëheqësia e re e LDK-së dhe Daci me njerëzit e tij kanë bërë homazhe ndarazi, ndërkaq nuk kanë munguar akuzat ndaj njëri tjetrit.

Pasi që bëri homazhe, Nexhat Daci edhe aty shfrytëzojë mediat për të bërë pak fushatë elektorale, duke thënë se partia e tij do të jetë vazhduese e frymës së Ibrahim Rugovës.

"Ne do ta marrin si filozofi politike dhe në këtë kam kritika, nuk e kuptojnë njerëzit se për 70 vitesh ishte Marksi dhe marksizmi, pse mos ta kemi për vitet e ardhshme Rugovën dhe rugovizmin si filozofi tonën. Prandaj them se subjekti i ri që po ndërtojmë do të qëndrojë në këtë binarë", ka thënë ai. Ndërkaq për kreun e ri të LDK-së lëshojë një mesazh. "Rugova ishte lider që nuk e distancoje askënd", tha ai, për të vazhduar më tej në akademinë përkujtimore që mbahet në Teatrin Kombëtarë, ku shkoi i paftuar. Ndenji disa çaste në këmbë, për t'u ulur më pas në rendin e pestë, kur dikush ia lëshojë një karrige.

Nga ana tjetër, në disa degë të LDK-së ku janë mbajtur takime përkujtimore janë lëshuar akuzat në adresë të Dacit dhe bashkëpunëtorëve të tij. Kështu në Deçan, kryesia e degës së LDK-së i quajti njerëzit e Dacit "plangprishës". "Ne besojmë se lufta shkatërrimtare që po zgjat tani e tjetër, në pëllëmbë të LDK-së, luftës për rrënimin deri në themel të kalasë së qajtur LDK, ngadalë po i vjen fundi", thuhet në komunikatën e kryesisë së degës së LDK-së në Deçan.

Gjatë gjithë fushatës për kryetar të LDK-së, emri i Ibrahim Rugovës është thirrur nga të dyja kapet, në përpjekje për të fituar vota. Ngjashëm mendohet se do të vepron edhe në zgjedhjet e ardhshme lokale e parlamentare. Të dyja kampet do të shtyhen se kush më shumë është pasues i Ibrahim Rugovës.



Nexhat Daci me bashkëpunëtorë



Ministrit e Qeverisë së Kosovës



Joachim Ruecker dhe Roland Kather

Politikë

REDAKTOR: Valon A.Syla
E-MAIL: valon.syla@gazetaexpress.com
TEL: 038 542 270 FAX: 038 542 270-2


I lëshohet rrugë pakos së Ahtisaarit

Prishtinë, 21 janar —

Me përfundimin e zgjedhjeve në Serbi, njëherësh i hapet rrugë edhe shpallimit të pakos për statusin e Kosovës nga ana e kryenegociatorit Martti Ahtisaari. Sot ministrat e jashtëm të vendeve të Bashkimit Evropian pritet të takohen në Bruksel, ku temë kryesor do të kenë zgjedhjet në Serbi. Ministrat e jashtëm të BE-së do ta analizojnë situatën

në Serbi pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve dhe rrjedhat e mëtejshme të bisedimeve për zgjidhjen e statusit të Kosovës pas zhvillimit të këtyre zgjedhjeve.

Pritet që tash kryenegociatori Ahtisaari t'i hapë letrat për palët në negociata, por ende nuk dihet saktë se kur mund ta shpallë ai propozimin e tij. Ngase varet shumë rezultati i zgjedhjeve në Serbi.



VOTUAN T

Radikalët prapë kanë fituar përqindjen më të madhe në zgjedhjet e fundit parlamentare në Serbi. Pasonjë Partia Demokratike dhe Partia Demokratike e Serbisë. Tani mbetet të shkëmbehen çmimet për formimin e koalicionit qeverisës i cili nuk do të kthente Serbinë në izolim.

Blerton Ajeti

blerton.ajeti@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 21 JANAR — Zgjedhjet parlamentare serbe, të konsideruara si më të rëndësishmet gjatë tërë dekadës së fundit, tregojnë se radikalët ende kanë përkrahjen më të madhe në Serbi. Serbisë i mbetet të zgjedh tani, gjatë formimit të koalicioneve qeverisëse, nëse dëshiron të shikoj drejt perspektivës evropiane, apo të kthehet në izolim, gjë të cilën diplomatët perëndimor e konsiderojnë destruktive për tërë rajonin.

Sipas rezultateve preliminare të publikuara nga instituti CESID, Partia Radikale Serbe, e udhëhequr nga Vojislav Sheshelj ka fituar përqindjen më të madhe nga të gjitha partitë tjera, 28.5%. Pason Partia Demokratike me në krye presidentin aktual serb Boris Tadic me 22.9%, dhe Partia Demokratike Serbe me në krye Vojislav Koshtunica me 17%.

Numri i madhë i votuesve ka thyer rekordin për pesë vitet e fundit. Sipas drejtorit të CESID, Zoran Lucic, numri i madhë i njerëzve të cilët kanë dalur të hedhin votën e tyre tregon për interesimin e madh për të ardhmen e Serbisë.

"Parashikimet tona kanë qenë se do të votojnë rreth 4 milion njerëz. Megjithatë, nuk do të quditesha nëse dalin më shumë se kaq. Kjo mund të shpjegohet me interesimin e madh të votuesve për të ardhmen e vendit. Kjo është shumë e mirë", ka thënë Lucic.

CESID ka identifikuar me dhjetëra parregullsi nëpër qendra

të ndryshme votimi nëpër tërë Serbinë, por janë konsideruar si të pandikueshme në rezultat në përgjithshëm të zgjedhjeve.

Marko Blagojevic nga instituti CESID ka thënë se ky institut ka hasur në parregullsi dhe se disa prej këtyre janë ditur edhe më herët.

"Edhe pse janë hasur me dhjetëra parregullsi në 8000 pika votimi, përshtypja e përgjithshme është se në princip votimi ka kaluar në rregull, në përputhje me standardet", ka thënë ai.

Megjithatë, Blagojevic ka thënë se këto parregullsi nuk mund të kenë efekt të mjaftueshëm për të ndryshuar rezultat në përgjithshëm.

Përqindja e përgjithshme e votimit deri në orën 20.00 ka qenë 60.3 përqind, ose 6.653.851 votues.

Edhe serbët e Kosovës kanë dalur në votime, dhe sipas raporteve nuk ka pasur asnjë incident. KFOR dhe SHPK kanë dalur në të gjitha pikë-votime serbe për të ofruar mbrojtje.

Tani mbetet që partitë lidere sipas votave të fituara të fillojnë garën e formimit të koalicioneve. Edhe pse Partia Radikale Serbe ka fituar përqindjen më të madhe, ka pak gjasa që kryeministri i tanishëm Koshtunica të hyj në koalicion me radikalët serb. Mbetet që Tadic dhe Koshtunica të bëjnë pazarin për koalicion, çmimi i së cilës sipas gjitha gjasave do të jetë që Koshtunica të kërkoj kryeministrinë prapë.

Rezultatet përfundimtare do të publikohen më 26 janar, ndërsa 30 ditë pas kësaj date duhet të konstituohet parlamenti i ri.

Putin nuk lëshon pe

Në vizitën që Kancelarja gjermane Angela Merkel i ka bërë Rosisë, është takuar me presidentin rus Vladimir Putin dhe ndër temat kryesore ka qenë edhe statusi i Kosovës. Megjithatë, Putin nuk ka ndryshuar qëndrimin sa i përket pavarësisë së Kosovës. Ai ka thënë se statusi i Kosovës nuk duhet të imponohet nga jashtë, dhe

ka paralajmëruar se vendimi duhet të jetë i pranueshëm si për Beogradin, ashtu edhe për Prishtinën.

"Rusia beson se është e papranueshme që një vendim për statusin e Kosovës të imponohet nga jashtë", ka thënë ai. Ai ka shtuar se Evropa nuk është e interesuar që Serbia të detyrohet të pranojë një

vendim i cili është turpërues për popullin serb. "Nëse injorohet integriteti territorial... atëherë popuj tjerë do të kenë të drejtën të thonë 'ne do të bëjmë të njëjtën gjë', ka thënë Putin. "Kjo nuk ka të bëjë vetëm me botën post-sovjetike, por edhe me vendet tjera, duke përfshirë shtetet Evropiane."



'E KALUAREN

REZULTATET PRELIMINARE

SRS	28,5%
DS	22,9%
DSS-NS	17%
G17 plus	6,8%
SPS	6,1%
LDP-LSV-GSS-SDU	5%

ULËSET NË PARLAMENT

SRS 80,

DSS 48

SPS 17

LDP 14

Lidhja e Hungarezëve të Vojvodinës, 3

Partia e Aksionit Demokratik, 2

Unioni i Romëve të Serbisë, 1

Partia e Romëve, 1



“Parashikimet tona kanë qenë se do të votojnë rreth 4 milion njerëz. Kjo mund të shpjegohet me interesimin e madh të votuesve për të ardhmen e vendit. Kjo është shumë e mirë”

CESID

Zgjedhje treguese

Serbët kanë dalë në votime. Rezultatet do të kenë rëndësi në Ballkan dhe më gjerë.

Economist

Për një shtet të vogël në Ballkan, Serbia ka marrë një pjesë të konsiderueshme të vëmendjes nga njerëzit në pozita të larta kohëve të fundit. Një javë përpara zgjedhjeve në Serbi, liderët apo ministrat e jashtëm të Greqisë, Rumanisë, Suedisë dhe Sllovakisë kanë vizituar Serbinë. Senati i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka aprovuar një rezolutë mbi zgjedhjet dhe mesazhet nga zyrtarët kryesorë të Bashkimit Evropian kanë vërshuar. Arsyeya është e qartë. Rezultatet do të kenë efekt në tërë rajonin.

Vendimi i 6.6 milionë votuesve serbë do të ketë efekt në atë që do të ndodhë në tërë Ballkanin. Nëse kujtimet e luftërave katastrofike të Jugosllavisë të viteve të 90-ta nuk janë arsye e mjaftueshme për liderët e huaj të brengosen për atë që do të ndodhë, atëherë një shikim në hartë mund të jetë. Anëtarësimi i pak kohë më parë i Bullgarisë dhe Rumanisë në BE ka lënë Ballkanin perëndimor si enklavë brenda saj.

Teorikisht votuesit serbë kanë një zgjidhje të qartë para tyre mes radikalëve ekstremë nacionalistë dhe një shtresë të partive pro-reformiste, pro-evropiane të quajtur si "Blloku Demokratik". Në praktikë kjo nuk është edhe aq e lehtë. Për momentin, partia më e madhe në Parlament është Partia Radikale e udhëhequr nga Vojislav Sheshelj, i cili është në gjykim në tribunalin e Hagës. Përkrahësit e saj nacionalistë janë bashkuar në numër të madh nga ish shtresa e mesme, statusi dhe vendet e punës të së cilës janë shtatërruar gjatë 17 viteve të fundit nga luftërat dhe sanksionet, dhe tani nga shtrëngimet e tranzicionit ekonomik.

Blloku Demokratik përfshin partinë e Vojislav Koshtunicës, kryemnistin e tanishëm serb, dhe atë të Boris Tadic, presidentit serb. Koshtunica është një nacionalist konservativ i cili ka pak dashuri për Tadicin. Por, rezultati mund t'i shtyjë që të dy t'i mbajnë hundët poshtë dhe të punojnë së bashku.

Sondazhet më të fundit sinjalizo-

jnë se radikalët do të fitojnë afërsisht një të tretën e votave, partia e Tadic ndoshta një të katërtën dhe Koshtunica, duke përfshirë aleatin kryesor, ndoshta një të pestën. Kështu që Koshtunica mund të mbajë balancën e fuqisë. Ka pak gjasa që ai të futet në koalicion me radikalët, por varësisht nga rezultatet e votave, çmimi i tij për t'u futur në koalicion me Tadicin mund të jetë kryeministria. Nëse nuk formohet asnjë koalicion, atëherë do të duhet të mbahen zgjedhje të reja.

Kalkulusi zgjedhor serb ka domethënie për tërë pjesën tjetër të Evropës sepse më 2 shkurt këtu vendi do t'i prezantohet plani i përpiluar nga OKB-ja për Kosovën. Qysh nga viti 1999, ky vend i dominuar nga shqiptarët ka qenë nën jurisdiksionin e OKB-së, edhe pse teknikisht pjesë e Serbisë. Plani, si efekt, do të përshkruajë pavarësi për Kosovën, një rezultat i cili kundërshtohet nga të gjithë liderët serbë. Reagimet do të ndryshojnë nëse dhe kohën, kur të vjen kjo.

Radikalët brengosen më shumë për Kosovën sesa për të ardhmen e Serbisë brenda Evropës. Në anën tjetër të peshores, edhe pse zëdhënësit e Tadic nuk e thonë atë aq publikisht, nëse humbet Kosova, partia e tij nuk do të kërkojë të shkaktojë kërdi në rajon duke izoluar Kosovën dhe duke sabotuar ringjalljen e bashkëpunimit rajonal. Pozicioni i Koshtunicës është diku në mes të këtyre.

Qeveria e Koshtunicës ka arritur sukses në bindjen e Rosisë që të kundërshtojë pavarësinë e Kosovës. Nëse Rusia përdor veton e saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, të cilën gjë mund ta bëjë, dhuna mund të shpërthejë. Dhe, edhe pse duke mos përfillur ligjin ndërkombëtar, shumë shtete do të njohin pavarësinë e Kosovës. Nëse kjo ndodh, efektet do të ndihen në Bosnjë. Liderë serbë atje janë të vendosur të përdorin pavarësinë e Kosovës si precedent dhe si shembull për shpresat e tyre shqëputëse. Koshtunica sigurisht do të përkrahte këtë; Tadic jo. Sidoqoftë, pasiguria dhe trazirat do të ishin të dëmshme për rajonin dhe kështu për Evropën si tërësi.

deri **8** Mbps
internet



+ **50** TV
kanale

prej **9.95** EUR



Kartelat mbushëse mund të i bleni në:

- **INFOTRADE** (Rr. Rexhep Mala, Nr 5, Aktash)
- **MOBILE ELECTRONIC** (Rr. Qamil Hoxha 8/2, Qendër)
- **GSM HOUSE** (Qyteza Pejton)
- **MOBI SHOP** (Rr. UÇK, Qafe)
- **BESA MOBISHOP** (Pallati I Rinisë)
- **DATA COM** (Kroi i Bardhe, Lokali Nr 9, Dardani)
- **COMTRADE** (Rr. Eqrem Qabej)
- **KOSOVA PHONE** (Rr. Perandori Justinian Nr. 7/7, Qyteza Pejton)
- **LINK PLUS** (Rr. Nëna Terezë Nr. 41/26, Qendër)
- **KOSOVA PHONE** (Rr. UÇK)
- **SIEMENS** (Lidhja e Prizrenit Nr. 40, Tregu i gjelbërt)
- **NEED 4 SPEED** (Qendra Tregtare, Bregu i Diellit)

Nacionale

REDAKTOR: Ilir Mirena
E-MAIL: ilir.mirena@gazetaexpress.com
TEL: 038 542 270 FAX: 038 542 275

Votuan 45 mijë shqiptarë

PRESHEVË, 21 JANAR — Edhe në Luginë të Preshevës të dielën janë mbajtur zgjedhjet parlamentare të Serbisë. Në orën 7 të mëngjesit janë hapur 130 vendvotime sa janë në Luginë, ku mundësinë e votimit do ta kenë rreth 70 mijë votues të regjistruar, pjesa dërmuese e të cilëve janë shqip-

tarë, rreth 45 mijë. Burimet nga koalicioni i shqiptarëve të Luginës së Preshevës kanë njoftuar se deri në ora 14 në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe të Medgegjës ka votuar mbi 20% për qind e trupi elektoralit shqiptar. Ndërkohë, rreth orëve të mesditës, të drejtën e tyre qytetare e kanë shfry-

tëzuar edhe përfaqësuesit e listës së Koalicionit të Shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Këto zgjedhje po përcillen me interesim nga vëzhgues të shumtë ndërkombëtarë, ne veçanti të OSBE-së dhe nga vëzhgues të partive serbe dhe shqiptare, pjesëmarrëse në këto zgjedhje.

Fiks tri arrestime

Agim Bytyqi, Kadri Sylejmani dhe Nasid Nuhi janë personat që ka arrestuar policia me akuzën për korrupsion. Arrestimi i tyre është bërë i mundur pas xhirimeve të fshehta të emisionit Fiks Fare të televizionit Top Channel nga Shqipëria. Për 550 euro, ata i kanë dhënë patentë shoferin një personi që mezi ndizte veturën.

Jeton Musliu

jeton.musliu@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 21 JANAR — Policia ka arrestuar tre instruktorë të cilët janë kapur me presh në dorë duke shitur patentë shoferi.

Agim Bytyqi, Kadri Sylejmani dhe Nasid Nuhi janë tre personat nga komuna e Prizrenit, të cilët kanë përfunduar prapa grilave.

Ata janë ndaluar nën akuzën për shpërdorim të detyrës, korrupsion dhe marrje rryshfeti.

Këtë arrestim e konfirmon për Express edhe zëdhënësi i SHPK-së Veton Elshani, i cili në të njëjtën kohë nuk pranon dhënien e shumë informacioneve.

"Janë ndaluar disa persona për këtë rast, por nuk mund të them diçka më shumë", thotë zëdhënësi i SHPK-së.

Ndërkohë, burime të sigurta të Express tregojnë se kundër Agim Bytyqit, Kadri Sylejmanit dhe Nasid Nuhit, prokurori ka shqiptuar masën e ndalimit prej 72 orësh.

Këta persona brenda afatit ligjor do të dalin para gjykatësit të procedurës paraprake, i cili do t'ua shqiptojë një vendim tjetër.

Ky vendim mund të jetë vazhdim i paraburgimit prej 30 ditësh deri në kompletimin e hetimeve ose në raste të rralla në mungesë provash, edhe lirinim të arrestuarve.

Por, në bazë të provave këtyre zyrtarëve pritet t'ua vazhdohet

paraburgimi, pasi ata janë xhiruar gjatë tërë kohës derisa merrnin rryshfet.

Këta ish zyrtarë janë xhiruar gjatë tërë kohës si duke biseduar pazarin me klientin, brenda duke mbushur testin apo duke hyrë në veturën e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit për të dhënë provimin në vozitje.

Kështu vetëm pesë ditë pasi ky xhirim, policia ka identifikuar personat e përfshirë në këtë rast.

Edhe pse identifikimi i tyre ka qenë shumë i lehtë për t'u bërë, ngase fytyrat e tyre janë parë gjatë tërë kohës në televizion, policia vetëm pas rreth një jave ka arritur të ndalojë këta persona.

Arrestimi i tyre është bërë i mundur pasi ditë më parë televizioni privat nga Shqipëria, Top Channel, ka transmetuar një xhirim të fshehtë në të cilën shiheshin këta tre persona.

Në këmbim të 550 eurove, ata i dhanë patentë shoferin një per-

soni i cili mezi ndizte makinën.

Në këtë xhirim të transmetuar në emisionin Fiks Fare, këta instruktorë shihen duke qeshur dhe duke i dhënë zemër kandidatit të tyre, i cili në bisedë e sipër e pranon se në tërë jetën e tij ka vozitur vetëm traktor.

"Mos ke dert, hajt se ke me e dhënë", i drejtohet kandidatit në fillim njëri nga instruktorët i cili



për t'ia larguar emocionet "presë" së tij, qeshte derisa hynte në makinë.

Në këtë xhirim shihet qartë edhe vetura e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit derisa në fund të emisionit Fiks Fare, drejtuesit e tij treguan para kamerës edhe patentën e marrë me para.

Përveç policisë, në hetimin e këtij rasti janë përfshirë edhe inspektorë për kontrollimin e personave të cilët janë të licencuar nga MTPT-ja.

"Menjëherë pas publikimit të incizimeve në televizionin e Shqipërisë, ministria jonë ka dërguar një ekip në Prizren për hulumtimin e këtij rasti dhe në bazë të rezultateve ata persona besoj se do të ndëshkohen", është shprehur Shefki Ukaj, zëdhënësi i MTT-së. Për marrjen e një patentë shoferi ndiqen disa procedura të thjeshta, të cilat fillojnë me regjistrimin në një autoshtetë.

Tridhjetë orë praktikë në vozitje dhe tridhjetë orë tjera në teori janë të vetmet përgatitje që një kandidat i kryen para se të hyjë në provim.

Pas përfundimit të këtyre orëve, kandidati mund të hyjë në provim dhe nëse bën mbi 30 pikë në testin e teorisë dhe nuk bën gabime në vozitje, ai merr patentë shoferin.

“ Arrestimi i tyre është bërë i mundur pasi ditë më parë televizioni privat nga Shqipëria, Top Channel, ka transmetuar një xhirim të fshehtë në të cilën shiheshin këta tre persona.”

Qentë e rrezikshëm

Drenas, 21 janar - Banorët e fshatit Bushat të komunës së Drenasit i kanë shkruar një letër udhëheqësve të kësaj komune, përmes së cilës ata kanë kërkuar eliminim të menjëhershëm të qenve endacakë në Drenas, të cilët shpeshherë kanë kërcënuar jetët e qytetarëve. Kohë më parë, dy fëmijë kanë pësuar lëndime nga qentë, mirëpo ata i kanë shpëtuar nga më e keqja

kalimtarët e rastit. Zyrtarët e Drejtorisë komunale për Mbrojtje Civile e Gatishmëri Emergjente në Drenas kanë thënë se kërkesa e qytetarëve është marrë me një seriozitet të lartë dhe se, sipas tyre, drejtoria do të merr të gjitha masat adekuate për ta zgjidhur njëherë e përgjithmonë këtë problem. Afrim Prokshi, drejtor i DMCGE-së, ka kërkuar asistencë nga Shërbimi Policor i Kosovës

në këtë komunë. Sipas tij, derisa të fillojë aksioni për eliminimin e qenve endacakë, pjesëtarët e SHPK-së do të jenë të pranishëm në rrugë dhe lokacione të ndryshme, sidomos gjatë intervalit kohor kur nxënësit duhet të shkojnë në shkollë, por edhe kur të kthehen në shtëpi. Edhe vetë Prokshi pranon se qentë paraqesin rrezik për jetën e qytetarit, ndërsa numri i tyre është i kon-

siderueshëm. Vetëm gjatë dy viteve të fundit, në këtë komunë janë eliminuar mbi 700 qen endacak nga Shoqata e Gjetarëve "Drenica". Drejtori Prokshi ka siguruar se aksioni për eliminim e qenve endacak në komunën e Drenasit, do të filloi shumë shpejtë, kurse në këtë aksion do të përfshihen 10 bashkësi lokale me 43 fshatra.

(Jeton Rushiti)

Surroi i sigurt



FOTO: FISNIK DOBRECI

Policia i heq sigurimin Veton Surroit. Ata arsyetohen se nuk ka më rrezik për të. Zyrtarët e partisë ORA i kërkojnë policisë shpjegime për këtë. Express ka korrespondencat e zyrtarit të lartë të policisë Bard Larsen dhe sekretarit të ORA-s Ylli Hoxha

Artan Behrami

artan.behrami@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 19 JANAR — Veton Surroi nuk do të sigurohet më nga disa pjesëtarë të Njësitit për Siguri të Lartë, të cilët veprojnë në kuadër të policisë së UNMIK-ut dhe SHPK-së.

Kështu kanë vlerësuar zyrtarët

e lartë të policisë të cilët kanë treguar se hetimet në lidhje me shpërthimin në zyrën e Partisë Reformiste ORA në prill të vitit 2005, kanë përparuar shumë.

Por, në të njëjtën kohë, këta zyrtarë nuk kanë treguar nëse kanë arrestuar dikë në lidhje me këtë shpërthim i cili në atë kohë pati demoluar pothuajse tërësisht

zyrën e kësaj partie.

Lajmin se pjesëtarët e këtij njësi-ti nuk do ta sigurojnë më Surroin, kryetarit të kësaj partie ia ka dërguar vetë shefi i këtij komisioni.

Bard Larsen ia ka komunikuar këtë informacion kryetarit të ORA-s përmes një letre të cilën e ka edhe Express.

Këtë letër Larsen ia ka dërguar

ORA-s më 15 janar të këtij viti, duke e sqaruar atë për vendimin e marrë.

Përveç kësaj, në fund të letrës ndodhen edhe emrat e major Granit Fetahut i cili është shef i trupës për sigurinë e personave të rëndësishëm në SHPK, si dhe emri i kapitenit Faton Pllana, gjithashtu pjesëtar në këtë polici.

Por, vetëm pak ditë më vonë, zyrtarët e Partisë Reformiste ORA i kanë kthyer përgjigje zyrtarit Larsen duke i kërkuar në të njëjtën kohë edhe disa sqarime të tjera.

Në këtë letër, të cilën gjithash-

tu e posedon Express, kërkohet që kjo parti të informohet në lidhje me zhvillimet të cilat kanë bërë që kjo shkallë e rrezikshmërisë të ulet në nivelin zero.

"Kërkojmë të dimë se cilat parametra të sigurisë që kanë avancuar nga vlerësimi i fundit të cilat kanë sjellë ndryshimin e vlerësimit mbi sigurinë personale të z. Surroi", thuhet në paragrafin e dytë të kësaj letre.

Në përgjigjen e ORA-s dërguar policisë vetëm tri ditë më vonë, të enjten më datë 18 janar, kërkohet nga zyrtarët e policisë që të sqarohet se kush janë autorët e vënies së mjetit shpërthyes në zyrat e kësaj partie.

Në të njëjtën kohë, zyrtarët e ORA-s në letrën e tyre të nënshkruar nga Ylli Hoxha, sekretar i kësaj partie, kërkojnë të njoftohen nga policia se cilat masa ndëshkimore janë ndërmarrë ndaj këtyre personave.

Por, zyrtari i ORA-s këtë letër nuk ia ka dërguar vetëm Bard Larsen, shefi i këtij komisioni.

Hoxha në kërkesën e tij dhe partisë në të cilën ai bën pjesë, ia ka dërguar edhe zyrtarëve më të lartë të policisë, përfshirë edhe komisarit Stephen Courtis dhe zëvendëskomisarit Sheremet Ahmeti.

Ndërkohë zyrtarë të policisë nuk japin ndonjë sqarim në lidhje me arsyen e largimit të personave që sigurojnë kryetarin e ORA-s apo nëse për rastin e shpërthimit në zyrën e kësaj partie është arrestuar dikush.

Express ka kontaktuar Tom Lee, njërin nga zyrtarët për informim të kësaj policie, i cili nuk tregon asgjë në lidhje me këtë, duke sqaruar se për këtë nuk ka informacione.

Përndryshe, këta policë janë emëruar për të siguar Veton Surroin menjëherë pas eksplozimit të një mjeti shpërthyes në zyrën e tij në prill të vitit 2005.

Në atë kohë patën reaguar të gjithë duke e dënuar këtë akt të dhunës ndaj kryetarit të partisë opozitare ORA.

Deri më tash ai sigurohej nga këta policë, por tash e tutje ai nuk e gëzon më këtë mbrojtje pasi është konstatuar nga policia se rreziku ka kaluar.

SLOT MACHINES • ARISTOCRAT POKER • ELECTRONIC ROULETTE

XANADU club

Standarde Europiane • Paisje dhe aparaturë e re • Për mysafir pijet gratis

Orari i punës
11:00 - 04:00

Gjendemi në:
Rr. Luan Haradinaj 32
(Përballë Stac, të Policisë nr.1)
Tel.: 038 248 501

Ju dëshirojmë fat dhe argëtim

18 gradë celsius në Prishtinë

PRISHTINË, 21 JANAR — Temperaturat e larta që kanë mbretëruar gjatë këtyre ditëve në Kosovë, të dielën e kanë arritur kulmin, duke u ngritur në 18 gradë celsius. Përderisa një vit më parë, në varimin e Ibrahim Rugovës kishim temperatura prej -17 gradë celsius. Por në fillim të javës priten përsëri ulje të temperaturave, ku në mesin e javës do të ketë edhe reshje të borës dhe shiut.

Meteorologët parashohin që gjatë kësaj jave të ketë reshje të shiut dhe nëpër vende malore edhe reshje bore. Temperaturat të hënën do të sillen nga 12 gradë celsius deri të ato minimale 1 gradë celsius. Ndërsa të mërkurën do të kemi rënie të dukshme të temperaturave, ku do të sillen nga ajo më e larta 5 gradë deri në -2 gradë celsius. Ndërkaq edhe në Tiranë thatësira do të mbi-

zotërojë në ditët në vijim. Ndërsa KESH-i ka ngritur "sytë nga qielli" në pritje të reshjeve të shiut, parashikimet e meteorologjisë tregojnë qartë se edhe gjatë ditëve të ardhshme nuk do të ketë reshje shiu. Për herë të parë i gjithë vendi po përjeton një dimër pranveror. Kështu, sipas parashikimeve, ditët e ardhshme do të mbi-zotërojë mot i kthjellët dhe me vranësira të dobëta

gjatë ditës. Për herë të parë temperaturat ekstreme të ajrit në zonat malore do të jenë nga -1 gradë celsius minimale dhe 11 gradë celsius maksimale. Në vendet e ulëta temperaturat do të zbrisin deri në -3 gradë celsius dhe ato maksimale do të jenë 11 gradë. Në bregdet temperaturat minimale do të zbrisin 5 gradë celsius, ndërsa ato maksimale do të ngjiten deri në 17 gradë celsius.

LDK dhe LD të bashkuara në akademinë përkujtimore për Rugovën.



FOTO: ASTRIT IBRAHIMI

Bardh Franqu

bardh.franqu@gazetaexpress.com

FERIZAJ, 21 JANAR — LD-ja me Adem Salihajn javën e kaluar

kishte paralajmëruar se do të mbante një akademi përkujtimore për kryetarin Rugova dhe atë në Shtëpinë e Kulturës "Hivzi Sulejmani". Nuk dihen motivet pse kanë hequr dorë nga kjo. Këshill-

tarët nga ky subjekt i ri, të dielën i janë bashkuar këshilltarëve të LDK-së në Asamblenë Komunale të Ferizajt dhe bashkërisht kanë mbajtur akademinë përkujtimore për presidentin e ndjerë Rugova.

Bashkim i përkohshëm

Në këtë akademi të organizuar nga Kuvendi Komunal, kanë munguar përfaqësuesit e PDK-së, partisë më të madhe opozitare. LDK-së dhe LD-së i janë bashkuar këshilltarët nga AAK-ja, PSHDK-ja dhe PDAK-ja si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare.

Shefi i grupit parlamentar të PDK-së, Agim Berisha, kishte këtë koment të shkurtër: "Nuk kemi dashur të jemi pjesë e vrapimit për përfutje të krahëve të LDK-së nga personaliteti i presidentit Rugova. Këto dy grupime kishin paralajmëruar manifestime të ndara që më parë, prandaj ne nuk deshëm të përzihemi".

Në akademinë përkujtimore fjalën e rastit e mbajti kryetari i komunës, Faik Grainca, i cili është edhe anëtar i trupit prej 16 anë-

tarësh, i caktuar nga Kryesia Qendrore e LDK-së për riorganizimin e Degës së LDK-së në Ferizaj. Grainca me emocione foli për veprën e presidentit Rugva. Rugovën e cilësoi si Gandi i Evropës, i cili zhvilloi një koncept paqësor në Ballkanin e përgjakur. "Presidenti Rugova ishte arkitekti i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës", tha kryetari i komunës Grainca. Gjatë gjithë kësaj kohe, këshilltari Muhamet Ademi, i krahu të Adem Salihajt, ka lexuar gazetën, ndërsa ka qëndruar bashkë me pakë këshilltarët e këtij krahu që kanë mbetur në asamblenë komunale.

Në fund, kryetari Grainca, ftoi këshilltarët që të shkojnë për homazhe tek vorri i ish presidentit Rugova, për të cilët kishte siguruar një autobus.

Martohet me djalën e saj

Julia Gregg është nëna e nipit të saj. Julia Gregg, 34, u bë nëna e foshnjës së djalit të saj të adoptuar, Krenar Lleshi.

Ata tashmë kanë një vajzë së bashku, të voglën Hatë, dhe tash ata së shpejti edhe do të martohen zyrtarisht.

"Jemi në ekstazë", thotë Julia Gregg për gazetën The Sun.

Krenar Lleshi erdhi në Angli si 14 vjeçar nga Kosova- dhe gjeti strehë tek Julia Gregg dhe burri i saj, Steve. Lidhja martesore e qiftit filloi të zbehej dhe ata gradualisht erdhën deri tek ndarja. Atëherë Julia u dashurua në djalin e saj të adoptuar. Punët rrodhën ashtu që tash Julia ka një fëmijë me djalën e saj, Krenar Lleshin.

"Nuk ka asgjë më të bukur se vajza jonë, ajo është dhurata jonë nga Zoti. Ne nuk jemi ndryshe nga qiftet tjera", tha Julia për The Sun. Njerëzit murmurisin. Qifti rishtas është fejuar dhe thonë se janë shumë të lumtur.

"Unë e di se njerëzit murmurisin për ne, por ne jemi prindër shumë krenarë."

Burri i saj i ardhshëm është gjithashtu entuziast.

"Jam me të vërtetë i lumtur me Julien dhe Hatën. Ne jemi të fejuar", thotë Krenar Lleshi i cili tashmë është bërë vëlla i fëmijës së tij.

Një shok i këtij qifti bashkëshortor tregon se si u ndër-tua lidhja romantike mes këtij qifti.

"Shumë njerëz mendojnë se kjo është një marrëdhënie e veçante. Julia ishte një nënë shumë e mirë për Krenarin në fillim, por diçka më e thellë filloi të ndodhë midis tyre. Ajo nguronte në fillim, por në fund fitoi dashuri", tha miku i tyre per The Sun.

Steve, ish burri i Julias, nuk dëshiron të komentojë këtë lidhje. Një shok i tij thotë se ai vazhdon me jetën e tij, pa u brengosur për ish dashuricë të ish gruas.

“ Nuk ka asgjë më të bukur se vajza jonë, ajo është dhurata jonë nga Zoti. Ne nuk jemi ndryshe nga qiftet tjera. ”

Julia Greg



Julia Gregg med Krenar Lleshi och dottern Hattie.

Me nderime u varros togeri i ShPK-ës

PRISHTINË, 21 JANAR — Në fshatin Stravuçinë të Therandës, me nderime të larta u varros togeri i Shërbimit Policor të Kosovës, Isa Morina, i cili u vra në rrethana të paqarta më 19 të këtij muaji në rrugën Therandë - Malishevë. Kolegët dhe bashkëveprimtarët e tij çmuan lartë veprimtarinë e toger të ndjerë Isa Morinës. Vrasja e toger Isa Morinës u cilë-

sua si një humbje e madhe jo vetëm për familjarët, por edhe për Shërbimin Policor të Kosovës ku ai me përgjegjësi dhe përpikëri e kryente detyrën, u tha me rastin e varrimit të tij. Në varrimin e prestatit të SHPK-së merrnin pjesë familjarë, qytetarë të shumët nga Theranda dhe kolegë të tij. Kjo është hera e dytë që brenda një periudhe të shkurtër

kohore vriten prestatit të Shërbimit Policor të Kosovës në rrethana të paqarta. Pas hetimeve fillestare të bëra nga Drejtorati i Krimeve të Rënda që vepron në kuadër të Komandës Kryesore të Policisë në Prishtinë në bashkëpunim me Njësitin e Hetuesisë Rajonale në Prizren është arrestuar një e dyshimtë. Po ashtu janë konfiskuar vetura

dhe arma për të cilat dyshohet se janë përdorur për të kryer veprën. Policia ka bërë të ditur se është arrestuar një femër 24 vjeçare lidhur me vrasjen e togerit Morina. Mirëpo, për shkak të hetimeve, policia nuk bën të ditur identitetin e vajzës. Jo zyrtarisht mësohet se bëhet fjalë për Q. L. dhe ka qenë e dashura e togerit Morina.

Plumba për vëllain?



FOTO: FISNIK DOBRECI

Maliq Krasniqi nga Kamenica është vrarë me pesë fishekë pistolete. Policia dyshon se jetën ia ka marrë njëri nga tre vëllezërit e tij. Për këtë rast janë arrestuar tre vëllezërit e viktimës. Shkas mendohet të ketë qenë një kontest pronësor.

Jeton Musliu

jeton.musliu@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 21 JANAR — Vëllai ka vrarë vëllanë me armë zjarri. Kjo është tragjedia e fundit që ka ndodhur në Kosovë. Të dielën edhe pse dita ishte me diell, ajo ka qenë e errët për familjen Krasniqi nga fshati Dajkoc i komunës

së Dardanës (ish Kamenicës). Njëri nga tre vëllezërit e kësaj familjeje besohet se i ka marrë jetën vëllait të katërt, 32 vjeçarit Maliq Krasniqi. Motivet për këtë tragjedi ende nuk janë sqaruar nga zyrtarët e policisë, edhe pse të tre vëllezërit janë arrestuar në të njëjtën ditë nga policia.

Megjithëkëtë, burime të gazetës Express nga policia, jo zyrtarisht tregojnë se vrasja ka ndodhur për shkak të një kontesti pronësor.

"Tash për tash besojmë se konteksti pronësor është arsyeja kryesore, por ende nuk ka të dhëna të hollësishme", tregon burimi i gazetës. Viktima Maliq Kras-

niqi është vrarë të dielën rreth orës 11 e 30 minuta, i qëlluar nga një pistoletë e kalibrit 9 milimetra.

Në lidhje me këtë rast janë arrestuar tre vëllezërit Krasniqi, të cilët janë të moshave 21, 36 dhe 41 vjeç. Vëllai i vogël është i dyshuari kryesor. Megjithëkëtë, zyrtarë të policisë nuk duan të japin shumë informacione duke sqaruar se ngjarja ka qenë shumë e rëndë dhe e tërë familja është e tronditur.

"Policia nuk ka mundur t'i marrë shumë në pyetje sepse janë të tronditur, por në ditët tjera mendohet se do të ketë më shumë informacione", tregon ky burim. Në të njëjtën kohë, zyrtarë të policisë në Gjilan përmes një deklarate kanë dhënë pak të hollësi në lidhje me këtë rast. Sipas tyre, nga qendra e alarmimit policia në Kamenicë ka marrë një informatë për një rast të vrasjes në fshatin Dajkoc të kësaj komunë.

"Njësitet patrulluese, njësitet e hetimeve të kriminologjike dhe teknikës kriminalistike kanë dalë menjëherë në vendin e ngjarjes dhe kanë konstatuar se një shqiptar -kosovar 32 vjeçar, është vrarë me armë zjarri", ka sqaruar Nasir Ibrahim, zëdhënësi i policisë rajonale në Gjilan. Këta zyrtarë kanë sqaruar se në lidhje me këtë rast, si persona të dyshimta janë arrestuar tre vëllezërit e viktimës 21, 36 dhe 41 vjeçar.

"Gjithashtu është konfiskuar një revole e kalibrit 9 mm me pesë fishekë, me të cilën dyshohet se është kryer krimi", ka treguar zëdhënësi Ibrahim në komunikatën e tij.

Pavarësisht se janë arrestuar tre persona në lidhje me këtë vrasje, zyrtarët e policisë kanë treguar se rasti po hetohet nga Njësitit i Hetimeve Rajonale të Krimit. Ndërkohë vetëm në rajonin e Gjilanit gjatë javëve të fundit kanë ndodhur ngjarje shumë të rënda.

Përveç kësaj vrasjeje kur vëllai vret vëllanë, para pak ditësh një plak ka tentuar të dhunojë një 12 vjeçare, kurse disa ditë më vonë një 34 vjeçar ka varur vetën.



Parajs

TIRANË, JANAR — Gjithkush që ka hapur të paktën një herë një kompjuter duhet të ketë dëgjuar për piratët e internetit. Ata, të cilët kanë nxjerrë probleme për bankat më të sigurta, apo kanë thyer sistemet e sigurisë së organizatave të spiunazhit më të madh në botë, kanë disa vite që po "çelin" edhe

MDA
Management & Development Associates
Bashkëpunorët për Menaxhim & Zhvillim
next generation business strategies & solutions

DELEGIMI EFEKTIV

24 - 26 Janar 2007

Mërkuren deri të Premten

09:00 - 12:00

Salla e trajnimit në MDA
Prishtinë, Ulpianë
(përbalhtë Kishës Katolike)

Për më shumë informata apo për të siguruar vendin tuaj, na kontaktoni në: 038/500-147, 044/175-264; email: training@seemda.com web: www.seemda.com

...edhe 1 ditë

Për 3 paradite,
ju do të ndjekni
trajnimin në
MDA për...

...vetëm
89 EUR
për pjesëmarrës
(përfshirë TVSH-në)

Një orë për Rugovën

PRISHTINË, 21 JANAR — Në njëvjetorin e vdekjes së ish presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, të hënë më 22 janar të gjitha shkollat e Kosovës, ora e parë do t'i kushtohet jetës dhe veprës së presidentit të parë dr. Ibrahim Rugova. Ky vendim është marrë nga Agim Veliu, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. "Në njëvjetorin e vdekjes së

presidentit historik të Kosovës dr. Ibrahim Rugova, ministri i Arsimit, Shkencës e Teknologjisë z. Agim Veliu, mori vendim që, të hënë, më 22 janar 2007, në të gjitha shkollat e Kosovës, ora e parë t'i kushtohet jetës dhe veprës së presidentit Rugova", thuhet në komunikatën për media të lëshuar nga MASHT. Tutje në këtë komunikatë thuhet se

dita e hënë është ditë pune dhe nxënësit e mësimdhënësit duke punuar nderojnë kujtimin për presidentin Rugova, i cili përjetësisht mbetet intelektual dhe atdhetari i madh që i dha emër Kosovës e shqiptarëve. "Presidenti Rugova i nisi proceset politike me vizionin e qartë për pavarësinë e Kosovës, krijoi themelet e shtetit dhe me dinjtet prej

humanisti bëri që vendi ynë të identifikohet përjetësisht me emrin e tij. Ndaj fizike me presidentin ishte dhe mbetet më shumë se dhembje sepse Kosova humbi emblemen e pavarësisë dhe simbolin e humanizimit e të rezistencës për liri. Presidenti Rugova çmoi edukimin dhe përmes krijimit të sistemit të pavarur arsimor, vuri themelet e shtetit.



së piratës

në vendin tonë.

Shumë veta i quajnë "piratë të internetit", por ata e kanë mbiqajtur veten në shumë mënyra si hackers, krackers, masters etj. Me sa duket, në vendin tonë janë të mbrojtur nga gjithçka dhe nga çdokush.

"Në Shqipëri çdo person që ka

njohuri të shkëlqyera mbi kompjuterin mund të thyejë çdo sistem sigurie në botë dhe të mos kapet nga askush", shprehet Heliand Dëma, një ish-haker, e tanimë një nga punonjësit më të mirë të kompanisë amerikane "Apple" në Greqi, i cili sapo ka përkthyer sistemin "Macintosh" në shqip.

Sipas tij, në vendin tonë është shumë e thjeshtë të shkatërosh një sistem dhe të mos dënohesh nga mungesa e IP (Internet Protocol). "Internet Protokoll është një sistem kodifikimi, i cili përcjell në çdo abonent internetin në shtëpi. Por çudia qëndron në faktin se në gjithë botën çdo person që ka internet në shtëpinë e tij, gjithashtu ka edhe një sistem të kodifikuar personal(IP), i cili e dalton nga çdo përdorues tjetër interneti. Në vendin tonë ISP-të (Internet Service Provider) përdorin të njëjtën adresë për të gjitha qytetet e Shqipërisë", theksoi Dëma.

Sipas tij, është ky sistem i kodifikuar që bën të mundur identi-

Shqipëria mbete vend i artë për piratët e informatikës. Heliand Dëma, dikur "hacker" kibernetik rrëfen sekretet "e zanatit" që po lulëzon edhe në vendin tonë

fikimin e menjëhershëm të përdoruesit, i cili ka shfrytëzuar Internet Provider në mënyrë abuzive. "Në Shqipëri çdokush mund të ulet në një kafe internet dhe me pak zhdërvjelltësi në përdorimin e kompjuterit mund të hapë dhe të sulmojë çdo faqe e server në internet, madje duke mos përdorur asnjë masë mbrojtëse si Proxy (program që fsheh IP-në e përdoruesit)", theksoi ish-hakeri.

Nga ana tjetër ai u shpreh se edhe në vendet e Evropës piratët kanë gjetur mënyra të ndryshme për të fshehur këtë sistem kodesh, që përcjell sinjalin internet në çdo cep(IP). "Është e natyrshme që të arrish këtë gjë, po duhet një informacion tepër i madh për sistemet kompjuterike dhe serverët e ndryshëm.

Nga ana tjetër është vërtet e çuditshme që edhe sot kur jemi në shekullin e internetit në vendin tonë nuk ka asnjë sistem sinjalizimi apo parandalimi të haker-ave", shton më tej Dëma, duke argumentuar se ndoshta teknologjia me të cilën punohet në Shqipëri është tepër e prapambetur.

Sipas tij, kërkesa në rritje për kompjuterë personal në vendin tonë nuk ka sjellë veçse shtimin e numrit të personave që abuzojnë me hapësirat kibernetike. Ndërkaq, ai theksoi se shtimi në numër i piratëve shqiptarë ka sjellë edhe rezultatet e para.

"Ka pasur raste, që shumë kompani, të cilat ofrojnë internet me pagesë për shqiptarët, janë sulmuar nga piratë vendas". Sipas tij, një sulm në një faqe, e cila ofron shërbime të ndryshme, kërkon një aftësi të veçantë, si dhe një praktikë jo të vogël përpara tastierës elektronike.

"Në Shqipëri nuk ka asnjë kompani ose institucion, që duhet të merret me kontrollin e hapësirave kibernetike", theksoi Dëma duke

BE, LIGJ KUNDËR PIRATERISË

Parlamenti Evropian ka nxjerrë një ligj për sigurinë e hapësirave kibernetike, i cili detyron të gjithë shtetet që bëjnë pjesë në BE t'i zbatojnë. Në secilin nga këto shtete të BE-së për të pasur akses në internet kafe, çdo person është i detyruar të paraqesë një kartë identiteti, si dhe të firmosë në një listë, e cila e figuron si përdorues të internetit në këtë hapësirë kohore. Po ashtu individit, gjatë lundrimit të tij në hapësirat kibernetike, është i survejuar çdo sekondë nga një telekamerë, e cila është vendosur në çdo kompjuter. Kjo mënyrë nuk mund të thuhet se ka zhdukur përfundimisht sulmet në faqet e internetit në të gjithë botën, por i ka minimizuar disi ato. Gjithsesi, lufta ndaj haker-ave të internetit do të vazhdojë për shumë kohë derisa këta të fundit të mos jenë të aftë të gjejnë mënyra të reja për sulmin e faqeve në internet. Por, me sa duket, kjo luftë do të zgjasë gjatë, thjesht duke marrë shkas në një nga shprehjet më të njohura nga piratët: "Çdo gjë që projektohet nga njeriu, do të thuhet nga njeriu".

shtuar se ka vetëm një zyrë të Ministrisë së Brendshme, e cila merret me krimin ekonomik, por që nuk ka asnjë farë teknologjie për këtë fushë. Së fundi ai shtoi se është e nevojshme që edhe në vendin tonë të krijohet një ekip, që të merret me piratët e internetit, në mënyrë që të minimizojnë dëmet e shkaktuara nga "zotërinjtë e rinj" të kibernetikës.

(Shqip)

FedEx
Federal Express

Postë e shpejtë
ndërkombëtare.

Eqrem Qabej #164
Prishtinë
Tel: 038/ 544345, 038/ 544346
Cel: 044/ 503889

Ekonomi

REDAKTOR: Viktor Buzhala
E-MAIL: viktor.buzhala@gazetaexpress.com
TEL: 038 542 270 FAX: 038 542 275

Viti i privatizimeve në Shqipëri

Viti 2007 do të cilësohet viti i finalizimit të privatizimit për sektorët më të rëndësishëm të Shqipërisë. Përveç ndërmarrjeve të vogla në synimet e qeverisë janë dhe privatizimet e Albtelekom, INSIG, KESH, AMC-së, etj. Sipas Ministrisë së Ekonomisë, vlera e asetëve dhe shërbimeve të ndërmarrjeve më kryesore që aktualisht janë

pronë e shtetit dhe që janë në rrugën e privatizimit për t'u realizuar gjatë vitit 2007, konsistojnë në privatizimin e shpejtë të të gjitha këtyre asetëve, por duke u lidhur ngushtë edhe me procesin e rikthimit dhe të kompensimit të pronave ndaj pronarëve të ligjshëm. Sipas zëvendësministrit Eno Bozdo, synimi i qeverisë është finalizimi i të

gjitha proceseve të privatizimit brenda 2007. Gjithashtu procesi i privatizimit është i lidhur shumë ngushtë edhe me disa nisma të ndërmarra nga qeveria për të rritur në mënyrë të ndjeshme investimet, duke ofruar pronave shtetërore me çmime shumë atraktive dhe joshëse në favor të investimeve.

INDEXI



\$ 1.34



Chf 1.56



Lek 122.6



Denar 61.5



Nafta 50.50 \$



Ari 634 \$



Nikel 15.00\$



Plumb 0.73 \$



Zink 1.90\$

RRJETI I ASKUJT

Serbia sa herë që përdor rrjetin energjetik në Kosovë, i cili përdoret për transit të rrymës, nuk kërkon leje nga KEK-u. Ndërkohë, ka ditur ta bllokojë importin e Kosovës që do të duhej të kalonte nëpër rrjetin serb.



FOTO: FLSNIK DOBREC

Jasmin Rexhepi

PRISHTINË, 21 JANAR — Rrjeti ndërkombëtar prej 400 voltësh në Kosovë shpeshherë shpëton Kosovën nga kolapsi energjetik. Ky rrjet i cili është i

dedikuar vetëm për transit të energjisë elektrike, është edhe rruga lidhëse për importimin dhe eksportimin e rrymës për Kosovën dhe vendet fqinje nëpërmes këtij rrjeti.

Ndërsa, sipas disa zyrtarëve të

Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Serbia sa herë që shfrytëzon këtë rrjet për të importuar dhe eksportuar rrymë, nuk pyet askënd nga Kosova edhe pse e shfrytëzon rrjetin tonë.

"Kur i duhet Serbisë ky rrjet

për të importuar apo për të eksportuar energji elektrike me Maqedoninë, ajo nuk negocion me Kosovën sepse e konsideron si të veten. Në këtë mënyrë Serbia këtë rrjet e përdor si të ishte në bahçe të babës", tha një zyr-

tar i lartë në KEK.

Ndërsa nga korriku i vitit të kaluar ky rrjet monitorohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT).

Por, zyrtari nga KEK-u tha se

BE-ja kërkon ndryshimin e legjislacionit tatimor në Shqipëri

Legjislacioni tatimor parashikon të pësojë ndryshime më synim përafshim e saj me atë të Bashkimit Evropian. Burime pranë Administratës Tatimeve pohuan se zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimitit detyron Shqipërinë të rishikojë disa pika të legjislacionit aktual tatimor. "Rishikimi i legjislacionit tatimor do të bëhet edhe në përputhje të objektivave të qeverisë e cila

synon reduktim të taksave", pohon burimi i DPTT-së. Ndërkaq, gjatë vitit 2006 disa nene të legjislacionit kanë pësuar ndryshime, përmendim këtu uljen e kontributeve, rritjen e nivelit të akcizës për disa mallra dhe duke përfunduar me ndryshimet në "sistemin e taksave vendore". Ende nuk bëhet e ditur se në çmasë do preket ligji tatimor dhe çfarë

ndryshimesh konkrete pret BE përgjatë vitit 2007. Tek analiza e punës 1-vjeçare, kreu i Tatim-Taksave, Alfred Prifti nuk përmendi asnjë nga detyrat e institucionit të tij në kuadër të MSA-së, por vetëm faktin se rishikimi për të reflektuar programin e qeverisë "Berisha". Sipas Priftit, një ndër komponentët kyç të kësaj reforme ka qenë rishikimi i legjislacionit fiskal, me qëllim

reflektimin në të e programit të ri qeverisës për krijimin e lehtësirave fiskale si premisa për të çuar në krijimin e një klime të re marrëdhënies me biznesin, në uljen e ekonomisë informale. Gjatë 2006, janë ulur ndjeshëm kontributet e sigurimeve shoqërore të paguara nga punëdhënësit, ulje kjo në mbi 30% të kontributit të pagueshëm nga kjo kategori.

nga dy aspektet fizik dhe energjetik, KOSTT kontrollon vetëm njërin prej tyre.

"Nga aspekti fizik ky rrjet kontrollohet nga KOSTT-i. Ndërsa nga aspekti energjetik ky rrjet kontrollohet nga Serbia", tha ai.

Ndërsa, sipas zyrtarëve të KOSTT-it, nga vera e vitit të kaluar ky rrjet montohet nga ky operator dhe çdo energji që kalon përmes këtij rrjeti regjistrohet nga njëshorët.

"Prej korrikut të vitit të kaluar ky rrjet monitorohet prej KOSTT-it. Ne i kemi të gjitha të dhënat e regjistruara se sa kilovati rrymë kalon nëpër këtë rrjet. Andaj asgjë nuk mund të kalojë ilegalisht përmes këtij rrjeti", tha Fadil Ismaili, drejtor menaxhues i KOSTT-it.

Sipas tij, këto linja prej 400 voltësh janë mjaft stabile për të funksionuar. Por, Kosova nuk i ka të gjitha linjat 400 voltësh.

"Transmisioni është ai i cili

kontrollon rrjetin interkonektiv. Varshmeritë e ndërsjella janë evidente me vetë faktin se kalon energjia e njëri-tjetrit në vende të ndryshme. Ne jemi të lidhur me nivelin e tensionit 400 voltë dhe 220 me Serbinë, njëkohësisht jemi të lidhur me Maqedoninë dhe me Malin e Zi me nivelin 400 voltë. Jemi të lidhur me Shqipërinë në nivelin e 220 voltëve. Normal që kjo varshmeri për secilin është e dyanshme," tha Ismajli.

Linjat tranzitore të këtij rrjeti, sipas Zyrës së Rregullatorit Energjetik (ZRRE), kanë njëshorët të vendosur në çdo vend që ka rrjetin tranzitor. Sipas tyre, njëshorët e vendosur në Kosovë regjistrojnë energjinë elektrike që kalon nëpër territorin tonë.

"Çdo kilovat që kalon nëpër rrjetin ndërkombëtar në Kosovë, regjistrohet. Në çdo linjë ekziston nga një njëshor. Në Kosovë janë njëshorët të cilët e kontrol-

lojnë qarkullimin e rrymës brenda Kosovës. Ndërsa njëshorët të cilët janë në vendet tjera e regjistrojnë dhe kontrollojnë rrymën që qarkullon brenda territorit të tyre", tha Naim Bejtullahu, zëvendës drejtor i ZRRE-së.

Sipas Bejtullahut, transmisioni i Kosovës tashmë është i njohur ndërkombëtarisht. Por, një gjë të tillë e mohon Serbia.

"Në nëntorin e vitit të kaluar transmisioni i Kosovës është njohur ndërkombëtarisht, ndërsa Serbia ende vazhdon me mohu një gjë të tillë. Këto ndoshta edhe janë interesa momentale komerciale", tha Bejtullahu.


Vjedhja e rrymës nga rrjeti ndërkombëtar gjatë ditës dhe kthimi i saj gjatë natës është një fenomen që ka ndodhur përpara. Por, kjo mohohet nga zyr-

tarët. "Çdo kilovat që hyn dhe del nga Kosova, evidentohet. Në anën tjetër, në nivelin regional ekzistojnë qendra koordinuese të cilat në mënyrë automatike evidentojnë rrjedhën e çdo kilovati të energjisë në regjion. Në çdo moment dihet se kush sa shpenzon dhe ku shkon energjia. Për këtë janë të thirrur TSO-të në mënyrë që të mbajnë disiplinë në sistem", tha Ismajli.

AEROPORTI NDERKOMBETAR I PRISHTINES SH.A

ORARI DITOR I FLUTURIMEVE E HËNË, 22 JANAR 2007

Nr. SER SER.NO	ARRITJA ARRIVAL	NGA FROM	PËR TO	SHKUARJA DEPARTURE	OPERATORI OPERATOR
1	/	PRISHTINA	VIENNA	07:00	AUSTRIAN AIRLINES
2	09:15	ZURICH	ZURICH	10:00	SWISS INT'L
3	10:50	ZURICH	ZURICH	11:40	HELLO AG
4	11:45	TIRANA	TIRANA	12:25	ALBANIAN AIRLINES
5	14:15	ISTANBUL	ISTANBUL	15:15	TURKISH AIRLINES
6	14:30	BUDAPEST	BUDAPEST	15:15	MALEV
7	15:00	LJUBLJANA	LJUBLJANA	15:45	ADRIA AIRWAYS
8	15:45	VIENNA	VIENNA	16:40	AUSTRIAN AIRLINES
9	16:00	LONDON	LONDON	17:00	BRITISH AIRWAYS



Trusti i Kursimeve Pensionale në vitin 2006

Viti 2006 shënoi edhe një vit të përmbyllur me sukses nga TKPK-ja. Strategjia e investimeve ka ndryshuar ndjeshëm për ta ngritur shkallën e profitit për kontribuesit në TKPK. Njëkohësisht, gjatë këtij viti TKPK ka shtypur dhe shpërndarë përmes Postës së Kosovës 193 mijë pasqyra individuale, me anë të të cilave kontribuesit janë njofitur për gjendjen në llogarinë e tyre për pension e cila mbahet në Trust. Këta hapa konkret kanë për qëllim avansimin e vazhdueshëm të menaxhimit të mjeteve në të mirë të kontribuesve nga Kosova, si dhe ta ngrisin cilësinë e shërbimeve që TKPK si institucion iu ofron qytetarëve të Kosovës, pjesëmarrës në skemën e kursimeve të obligueshme pensionale.

Bordi Udhëheqës i TKPK-së në fillim të vitit ka shqyrtuar mundësinë e investimit të një pjese të mjeteve të kursyera në Trust në letra borxhi. Letrat e borxhit janë ato që lëshohen nga institucionet e ndryshme dhe qeveritë e shteteve, e të cilat më pas obligohen t'i paguajnë pronarit të letrës kamatë fikse në periudha të caktuara

kohore, si dhe në fund të periudhës huamarrëse t'ia kthejnë shumën fillestare të huasë, apo kryeqjënë. Letrat janë instrumente financiare të cilat në afatgjatë kanë kthim të mirë të investimeve dhe bartin një shkallë modeste të rrezikut. Siç është publikuar edhe më herët, Bordi Udhëheqës i TKPK-së i ka zgjedhur dhe angazhuar dy menaxhues të mjeteve që kanë ekspertizë të afarimit në këtë lëmi. Këta janë:

Schroders - institucion i themeluar në vitin 1804, me seli në Luksemburg. Klientët e tyre kryesorë janë korporatat, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, autoritetet qendrore dhe lokale, etj.

ECM - themeluar më 1999, selia e të cilit është në Londër. ECM ka filluar punën si iniciativë e individëve me përvojë shumë vjeçare në këtë lëmi. Për një kohë të shkurtër ata kanë arritur të bëhen njëri ndër vepruesit më atraktiv në këtë fushë të investimeve duke tërhequr nën menaxhim sasi të konsiderueshme të mjeteve.

Klientët kryesor të tyre janë bankat komerciale, fondet pensionale, bankat qendrore, korporatat, kompanitë e sigurimeve, etj.

Kthimi neto vjetor nga investimet e mjeteve të TKPK-së për vitin 2006 ka qenë 8%. Gjatë vitit 2006 shuma e përgjithshme e mjeteve nën menaxhim është rritur nga 142 milionë në vitin 2005 në mbi 213 milionë në fund të vitit 2006. Këto janë para të 215 mijë kontribuesve në skemën e kursimeve të obligueshme pensionale.

Gjatë muajit maj të vitit 2006 TKPK ka shtypur, ndërsa Posta e Kosovës i ka shpërndarë, gjithsej 193 mijë pasqyra të llogarive individuale me anë të të cilave janë informuar kontribuesit mbi gjendjen e llogarisë së tyre në Trust. Atëbotë ishin gjenuar gjithsej 203 mijë pasqyra mirëpo për shkak të mungesës së informatave për vendbanimet e një numri të kontribuesve (10 mijë sosh) Trusti ka qenë i obliguar që ta bëjë shpërndarjen për vetëm 193 mijë pasqyra. 8 mijë nga këto janë

kthyer nga Posta e Kosovës për shkak të adresave të pasakta. Është shumë e rëndësishme që secili kontribues ta dorëzojë adresën e saktë në TKPK si dhe ta informojë Trustin në rast të ndryshimit të adresës, për shkak se raportimi që Trusti ua bën kontribuesve dërgohet përmes postës.

Gjatë këtij viti TKPK ka paguar benefite (apo ua ka paguar paratë e kursyera kontribuesve që i kanë plotësuar kushtet për marrjen e këtyre parave, pra kontribuesve që kanë arritur moshën 65 vjeçare, atyre që kanë fituar të drejtën e pensionit invalidor, apo familjeve të kontribuesve që kanë ndërruar jetë) në vlerë të përgjithshme prej 1 milion e 163 mijë eurosh, të cilat i janë paguar 1442 aplikuesve përgjatë vitit.

Zyra për Marrëdhënie me Publikun
Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Tel: (038) 244 337, lok. 206;
www.kpst.org
Komentet tuaja luteni t'i dërgoni në: info@kpst.org

**TË PUNOJMË SË BASHKU
PËR TA FORMËSUAR TË ARDHMEN.**

www.magazineforyou.com

KFOR **KΦOP**

**IPKO NET**

Rr. Nëna Terezië
RTK, Kati 5
Prishtinë, Kosovë
www.ipko.net

T: 038 20 30 40 00
F: 038 248 013
office@ipko.net

Konkurs për punë

Ipko Net është një ndër organizatat më të suksesshme në Kosovë, vazhdimisht në rritje. Suksesi e kemi arritur me anë të profesionalizmit, kreativitetit dhe punës ekipore. Pasiqë jemi duke u zgjeruar, vazhdimisht jemi duke kërkuar persona të talentuar të na bashkëngjiten në punën tonë. Kemi shpallur konkurs për 4 vende të lira pune:

Konkursi shpallet për postet:

Ndihmës/e në Administratë dhe Shitje (1 për Pejë, 1 për Mitrovicë, 1 për Gjilan dhe 1 për Ferizaj)

Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

Asistent/e në departamentin e Shitjes, pregaditja e kontratave dhe faturave, planifikimi i instalimeve, mirëmbajtja e fajllave, mirëmbajtja dhe azhurimi i intranetit, kontakti me klientë egzistues dhe potencial si dhe punët e receptionit.

Detyrat e Ndihmësit në Administratë dhe Shitje janë:

- Komunikimi me klientë ekzistues dhe potencial të Ipko Net
- Mirëmbajtja e bazës së të dhënave
- Kujdesi për bashkëpunim të suksesshëm ndërmjet klientit dhe Ipko Net
- Pranimi i thirrjeve telefonike, marrja e porositve dhe percjellja e tyre
- Komunikimi me departamentet tjera të Ipko Net
- Pregaditja e kontratave
- Pregaditja e faturave
- Organizimi instalimeve
- Komunikimi me partnerët / distributorët e Ipko Net
- Raportimi në baza ditore/javore dhe mujore
- Caktimet e takimeve sipas nevojës dhe mirëmbajtja e agjendës lidhur me takime
- Mirëmbajtja e fajllave

Nëpunësit e Ipko Net-it janë të rinj, komunikativ dhe energjetik. Në kompani çmohet kolegjaliteti, vetinicia dhe ndihma reciproke. Nëse jeni person që gjithashtu i çmon këto vlera, ju ftojme të na dërgoni biografinë e shkurtër me dokumentet përcjellëse në zyrë apo me email në office@ipko.net, duke specifikuar pozitën për të cilën aplikoni. Konkursi është i hapur deri më 29 Janar 2007. Vetëm kandidatët e zgjedhur do të kontaktohen.

Ndihmësi/ja në Administratë dhe Shitje duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Përvojë në punë administrative
- Të dijë të punojë me kompjuter: Word, Excel
- Njohuri të përgjithshme lidhur me internet (www, E-mail, ...)
- Aftësi të përpilimit të raporteve
- Të shkruajë dhe të flasë rrjedhshëm gjuhën angleze
- Të jetë komunikativ/e dhe i/e gjindshëm
- Të jetë i gatshëm të mësojë dhe të punojë në ekip
- Të jetë pedant/e në punë dhe në dukje
- Preferohet të ketë patent shoferi

2006

HP rekomandon Windows® XP.

Preferred Partner



€915

pa TVSH, €1.022 me TVSH
Përfshirë në €1500000
të çmimit në përfundim të punës

HP COMPAG eo7400
NOTEBOOK PC DHE DESKJET 480i
KOMPLETO ME BATERI JETEGJATË

- Intel® Centrino™ Duo Mobile Technology
- Microsoft® Windows® XP Home i vërtetë
- Wireless LAN i Integruar dhe Bluetooth



www.hp.com

Mbyllni marrëveshjen aty për aty. Me nx7400 ju fitoni HP bateri me jetë të zgjatur deri në 16 orë*, ekran të gjerë 15.4" dhe të ndritshëm. Së bashku me printer të lehtë dhe mobil (2kg), ju mund ta merrni nënshkrimin në marrëveshje pa marrë parasysh sa zgjatë dhe pa marrë parasysh ku jenil Produktivitet maksimal pa tejkallim të buxhetit tuaj - Çfarë mund të kërkonti tjetër?

NEGOCONI. SHITPNI.
NËNSHKRUANI. KUDO.

KOMPJËTERI ËSHTË
PERSONAL PËRSËRI.



Pronet: Veternik Zona Industriale p.n., Prishtinë, Kosovë, Tel: (038) 55 77 99, e-mail: sales@pronet-ks.com Vërejtje: *me blerjen opcionale të baterisë me ultra kapacitet ©2006 Hewlett-Packard Company, L.P. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Celeron, Celeron Inside, Centrino, Centrino Logo, Core Inside, Intel, Intel Logo, Intel Core, Intel Inside, Intel Inside Logo, Intel SpeedStep, Intel Vix, Itanium, Itanium Inside, Pentium, Pentium Inside, Xeon dhe Xeon Inside janë shenja dhe emra tregtarë të regjistruar të Korporatës Intel në Shtetet e Bashkuara dhe në vende tjera. Microsoft dhe Windows janë shenja dhe emra tregtarë të regjistruar të Korporatës Microsoft. Çmimet i referohen vetëm specifikave të përshkruara, janë të saktë në momentin e botimit dhe mund të ndryshojnë pa paralajmërim. Produktet janë subjekt i disponueshmërisë.

Bota

REDAKTOR: Faton Raçi
E-MAIL: faton.raçi@gazetaexpress.com
TEL: 038 542 270 FAX: 038 542 270-2

Është kapur vrasësi i gazetarit

Autoritetet turke kanë botuar fotografit të xhiruara nga kamera sigurie të personit për të cilin besohet së është i përfshirë në vrasjen e gazetarit të spikatur turk me origjinë armene, Hrant Dink. Në foto shihet një mashkull i ri

në momentin kur, siç konsideron policia, e vendos revolen në bel. Hrant Dink është varë të premtën, jo larg redaksisë së gazetës së tij në Stamboll, gjë që ka nxitur protesta të hidhura. Dink gjerësisht kishte shkruar

për masakrën ndaj armenëve gjatë ditëve të fundit të Perandorisë Otomane më 1915. Ogun Samast është arrestuar pasi që ishte identifikuar nga ana e babait të tij nga imazhet e marra afër skenës së vrasjes të së premtës në Stamboll.



Clinton e preferuar

SHBA: Hillary Clinton dhe Rudy Guliani udhëheqin në anketa

Washington - një ditë pasi që senatorja demokrate Hillary Clinton ka publikuar se do të hyjë në garë për zgjedhjet presidenciale të vitit 2008, hulumtimi i opinionit publik të cilin e kanë publikuar gazeta ditore The Washington Post dhe TV rrjeti ABC News, treguan udhëheqjen e saj bindëse para kandidatëve tjerë të partisë demokratike, duke përfshirë edhe kundërshtarin më serioz - senatorin Barack Obama. Në parazgjedhjet hipotetike partiake, Clinton do të fitonte 41 për qind të votave, shumë më shumë se Obama i cili në hulumtime fiton 17 për qind, dhe ish senatorit John Edwards me 11 për qind, si dhe ish nënkryetarin Al Gore me 10 për qind. Senatori John Kerry do të fitonte 8 për qind të votave, kurse askush prej kandidatëve tjerë më shumë se pesë për qind.

Rezultatet janë gati identike me ato të dhjetorit të vitit 2006, kur Clinton kishte fituar 39 për qind, Obama 17, kurse Edwards 12 për qind të votave. "Hulumtimi vërteton se Hillary Clinton ka statusin e favoritit në mes të kandidatëve të mundshëm për nominimin demokrat", vlerësoi John Cogen, drejtor i agjencisë Post, e cila kishte zbatuar anketën. Në anën republikane, ish kryebashkiaku i Nju Jorkut, Rudolf Guiliani udhëheq me 34 për qind të votave para John McCain, i cili fiton 27 për qind të përkrahjes. Askush prej kandidatëve tjerë potencialë nuk ka fituar përqindje dyshifrore të votave. Senatori nga Kanzasi, Sam Brownback, i cili të shtunën formalisht hyri në garë, sipas anketës së Washington Post-it, fiton një për qind të votave. Hulumtimi është bërë me 16 - 19 janar dhe ka përfshirë 561 demokratë ose zgjedhës të pavarur të cilët anojnë ka demokratët, dhe 344 republikan ose zgjedhës të pavarur që anojnë ka republikanët, në margjina të gabimit për pesë për qind për të dy palët.

Jutarnji List

Formulat e


I shpejtë, i lehtë dhe shumë i thjeshtë... Në realitet ai është i mbushur me shumë hapësira dhe burime, por jo pa ekuivoke. E-mail është një krijim i çuditshëm, i krijuar mes përzjerjes së letrave tradicionale, sms-ve, korrespondencave komerciale, bisedave. Herët apo vonë të gjithë arrijmë të kuptojmë se toka e premtuar e komunikacionit mund të zbulojë një terren të minuar, ku kërcëjnë lehtësisht raportet e punës dhe krijohen lindje të reja miqësisht. Është një eksperiencë me të vërtetë globale dhe ndarëse që revista e njohur "New York Times" i ka kushtuar një artikull të gjatë më 26 nëntor: "Yours truly, the e-variations".

Variantet e treguara nga kontrollet e imta nga aktorja Lola Ogunnaika janë përshëndetjet e panjohura dhe vuajtjet e korrespondencës elektronike. Është bërë gjithmonë e më e vështirë për t'u përshëndetur, në pjesën më të madhe të kohës, pikërisht për natyrën hibride të e-mail-it. Formulat klasike të lamtumirës së letrave tashmë na duken rituale të zbrazura edhe në komunikimin formal, por është gjithashtu e kujdesshme që arrijmë drejt shprehimeve më të zjarra dhe më të lirshme.

Një nga rezultatet më të kujdesshme është që sot shumë e-mail-e kalojnë aparatë dhe mbyllje, madje dhe firmat mund të shkojnë në çdo drejtim pa shumë përshtatje dhe veç të tjerash mund të pranohen menjëherë, me rezultate shkatërrimtare shpeshherë për raportet profesionale dhe njerëzore, siç nënvizojnë shumë të intervistuar nga revista e famshme "New York Times". Mes tyre, është edhe Judith Kallos, krijuese dhe themeluese e "Net-manners.com", një enciklopedi e vërtetë online e-mail. Lërimi pas kraheve formulat ceremoniale të shëndetit, anglosaksonët, tregon Kallos. "Blog"-et e saj lëvizin gjatë një shkalle e cila shkon drejt trugës më të gjatë "my sincerest thanks for your time and consideration", në atë më të ngushtë dhe në këtë moment shpërndahen "Best", duke kaluar për të "I remain yours truly, Warmest regards, Cordially".

Të përmbledhura, shumë të shkurtra, pothuajse duke iu bashkuar edukimit, përballemi të magjepsur

Si niset një e-mail dhe cila është shija e drejtë? Amerikanët dhe evropianët kërkojnë modele për një shkrim akoma për t'u shpikur.



dhe të kushtëzuar nga shpejtësia e postës elektronike, e cila lejon shkëmbimin e shumë letrave në pak minuta. Kur shkruajmë një e-mail duket sikur kemi gjithçka në një shpejtësi skëterrë. Gjuha e mesazheve përhapet me sigla dhe emocione. Në mbyllje emocionet mund të jenë të nevojshëm për të transmetuar ndonjë ngjyrim: një shkelje syri dhe ndonjë kritikë të ëmbël, një buzëqeshje ndriçon një e-mail të shpejtë (mund të bëhet më tërheqës duke pritur një refuzim. Por, këto gjëra mund të përdoren me "pikatore", është një lloj sikur të dërgosh një e-mail me puthje dhe përqafime nën zhargonin e e-mail-it xoxos), sidomos me persona të cilët nuk njihen, por që herët a vonë mund t'i takosh dhe nuk do të dëshiroje një shoqëri intime me ta.

Sinteza nuk duhet të shprehë vë-

mendje për bashkëbiseduesin, që mund të shprehet në kurë me detaje, me një pyetje ngacmuese, ndosh-ta me shumë fjalë e jo me pak. Shumë fjalë, mesa duken, janë vlerësuar më shumë nga femrat. Në librin e saj të famshëm dhe shumë të kundërshtuar, "The female brain", psikiatria Louann Brizendine pohon se femrat përdorin (dhe vlerësojnë) trefishin e fjalëve në krahasim me meshkujt. Mund të jetë një ekzagjerim, por para se të dërgojë një e-mail me një përshëndetje të ngrohtë, një zonjë duhet të mendohet të paktën dy herë. Kjo gjë në fakt vlen për të gjithë, si për femrat ashtu dhe për meshkujt. Pak më kujdes për personin, pikërisht atë që formulat e paraprirja shpesh mohohen. Me sa duket, kjo gjë bëhet për të bërë për vete personalizimin dhe mirësjelljen, të cilat lulëzojnë në rrjetet sajtesh

Abbas takon në Damask liderin e Hamasit

Udhëheqësit do të përpiqen të zgjidhin përplasjet mes fraksioneve Presidenti palestinez, Mahmoud Abbas, është në Siri për bisedime me një prej fraksioneve më me influencë në lëvizjen Hamas. Kjo është një përpjekje për të zgjidhur ndarjet e thella që ekzistojnë mes këtyre fraksioneve rivale palestineze.

Udhëheqja e Hamasit konfirmoi se bisedimet mes zotit Abbas dhe Khaled Meshaal do të zhvilloheshin në kryeqytetin Damask, ku zoti Meshaal jeton në mërgim. Diskutimet do të përqendrohen në përpjekjet e ripërtëritura për formimin e një qeverie të re palestineze të unitetit kombëtar.

Shefi i kabinetit të zotit Abbas, Rafiq Husseini i tha BBC-së se nëse qeveria e unitetit dëshon atëherë presidenti do të thërrisë zgjidhje të reja. Por ai shtoi se një zgjidhje për ndarjet mes fraksioneve palestineze mund të gjendej

BBC Shqip



e-mail-it

drejtimit janë gjermanët dhe francezët. Një sajt marketingu gjerman (www.marketing-boerse.de) bën një listë prej rreth 236 mënyrash për të nisur një e-mail, por edhe në Gjermani tendenca është drejt shkurtimeve dhe siglave të mesazheve. Për të mbyllur një mesazh shpesh herë ekonomia është maksimale: "Lg", ose më qartë "Liebe GruBe", përshëndetje të ngrohta, ose "Mfg" "Mit freundlichen GruBen" në një letër pune.

Francezët e shprehin edhe në rrjet dashurinë për gjuhën dhe lidhjen e traditave, siç dëshmon suksesi i "Langue sauce piquante" "blog"-u i dy projekteve të korrektoreve të "Le Monde" (correcteurs.blog.lemonde.fr/correcteurs). Nuk mrekulloj kështu vëmendjen maniake ndaj rregullave të e-mail-it (e ri pagëzuar "courriel" nga komisioni i përgjithshëm i terminologjisë). Rregulla të cilat po i përuhen urdhrat të shkurtësisë dhe thjeshtësisë. Më klasikja dhe francezja e formulave, "Je vous prie de bien vouloir agréer l'expression de mes sentiments les plus distingués", reziston vetëm në korrespondencat e shkruara më formalisht. Për e-mail, "politesse" këshillon tashmë për të komunikuar me "Bonjour" dhe për të përfunduar me "Cordialment" ose "Sinceres salutations".

me rregulla shumë të hollësishtme, ku sugerohen formula të hapjes dhe të mbylljes së një e-mail -i sipas shumë kombinimeve të ndryshme (niveli i njohjes, ti ose ajo, motivi i e-mail -it, moshë dhe gjinia e bashkëbiseduesit, qyteti dhe origjina).

Të themi të vërtetën, duket jo shumë i adaptuar për shumë vende kur ne i drejtohem njëri-tjetrit me "Ti". Përhëndetja është vendimtare. Nëse drejtohem me "JU", miqësohemi në shumë drejtime të përzemërta (përhëndetja të përzemërta, të ngrohta dhe gjithçka bëhet me shumë përzemërsi dhe dashamirësi). Shumë persona përpunojnë ose zgjedhin mënyrën e tyre të të përhëndeturit, personale dhe mirënjohëse: virtualisht i yti, më pëlqen, shëndet & puthje).

Ndërsa precizë dhe pedantë në këtë

Lidhja

Duhet të jetë kjo arsyeja që shpeshherë korrespondenca me e-mail mund të merret me vështirësi. Sepse lidhja çdo herë është ndryshe: avancen, ndalon, ndërpritet ose mund të ketë një gjendje të mirë, sipas fjalëve që zgjedhim për ta përdorur. Një lidhje përbëhet edhe nga "mbrojtja e hijeve", kënaqësitë, ndjeshmëritë dhe përballë shembëllimit nuk kemi shikime, tone zëri, shtrëngime duarsh pak a shumë të fuqishme, që të mund të na drejtojnë ne. Vetëm fjalë...

Kështu, para se të shkruajmë, pyetjet na ngacmojnë. Si të filloj? Mirëditë apo Mirëmbërëma? Dhe, nëse e lexon këtë e-mail natën? "I Dashur" nuk do të jetë pak konfidencialë? Do të ofendohet? Apo do ta keqkuptojë? Por "I Dashur" është shumë e ftohtë..., krijon distanca. E urrej, është përgjigjur "Sinqerisht i joti". Herën tjetër ishim të "Shpresoj t'ju takoj sa më parë. Më pëlqeni, ju përhëndes me shumë dashamirësi". Domi të thoni diçka? Si ta ndreqni? Ku të drejtoheni me Ti dhe Ju? Mirë, po përqendrohem, të shikojmë se si do të më përgjigjet. Por, jo zonja në këtë rast jam unë, më takon mua të drejtohem me Ti në fillim..., po kush e di se sa vjeç është...


Të krijosh lidhje të mira me e-mail është një lojë dani, një aktivitet me litar të vendosur, në të cilin ekuilibrat çlodhen herë pas here. Duke i studiuar, duke i lexuar ndërmjet vijave, duke guxuar paksa se si mund të reagojë personi tjetër, duke avancuar në mënyrë inkurajuese drejt rrugës së thjeshtësisë dhe nxehtësisë ose duke bërë të nevojshme dhe të nxituar formulat prapa. Apertura dhe mbyllja janë hapat vendimtare.

Shumë presona komunikojnë në shenjë të korrespondencës. Për shembull me "Bondi ose Salve", pasqyrimi herën e fundit ishte mjaft i ngrohtë, por është pak impenjuese kur bashkëbiseduesit nuk njihen. Kjo është paksa e vjetruar në raportet "një për një", por përsëri mbetet një shpëtim në korrespondencën elektronike.

Nëse shkëmbimi vazhdon, temperatura avash-avash fillon të ngrihet dhe termometrat e vërtetë të lidhjes janë gjithmonë ato, fillimet dhe mbylljet e e-mail-it.

Identifikohet vrasësi i Litvinenkos

Njeriu misterioz, i cili i ishte paraqitur Litvinenkos si Vladislav, kishte zier çajin në të cilin kishte vënë polonij.



Londër — Policia britanike ka identifikuar mashkullin për të cilin besohet se ka helmuar ish spiunin rus Aleksandar Litvinenkon, shkruan The Times - i londinez

Vrasësin e dyshimtë e kanë xhiruar kamerat e sigurisë në Aeroportin Heathrow, shkruan gazeta. Shokët e Litvinenkos pohojnë se burri ishte vrasës i paguar, të cilin e kishte dërguar Kremli dhe i cili ishte zhdukur disa orë

Times shkruan se policia ka vendosur t'i publikojë fotografitë e njeriut të cilin kamerat e kishin xhiruar më 1 nëntor, në ditën kur Litvinenkos iu keqësua gjendja, duke zbritur nga fluturimi nga Hamburgu. Por, megjithatë e përshkruan si njeri të gjatë me ndërtim shumë të fortë, diçka më të vjetër se 30 vjet, me flokë të shkurta dhe me vija të theksuara aziatike të fytyrës

Supozohet se kishte udhëtuar në të njëjtin fluturim sikurse Dimitrij Kovtun, biznesmen rus, i cili është nën hetime për shkak të kontrabandimit të materialit radioaktiv që është përdorur për helmim. - Besohet se ky njeri ka përdorur pasaportë lituaneze ose sllovaqe. Nuk është paraqitur në asnjë hotel në Londër dhe ka lëshuar vendin duke përdorur tjetër pasaportë nga EU-ja, ka thënë Oleg Gordievski, ish agjent i KGB-së dhe mik i Litvinenkos, i cili kishte bashkëpunuar për së afërmi me policinë në hetime. Litvinenko ishte takuar me Kovtunin në hotelin Millennium dhe ish agjentin Andrej Lugovoj. Më vonë iu është bashkuar edhe njeriu misterioz i prezantuar si "Vladislav"

Gordievski, ka thënë për Times ai dhe se Vladislavi i kishte zier çajin Litvinenkos.

-Aleksandri ka qenë i bindur që uji nga kupa ka qenë vetëm i vakët dhe se poloniumi 210 i shtuar ka ngrohur pijen, kështu që çaji ka qenë i nxehtë - ka thënë Gordievski.

Times

Përforcimi amerikan ka arritur në Bagdad

Forcat irakiane nuk po kanë sukses ta kontrollojnë dhunën në Bagdad. SHB-të kanë dërguar ushtarë shtesë në kryeqytetin irakian Bagdad, derisa dhuna anembanë vendit po zgjerohet. Brigada prej më se 3 000 ushtarë amerikanë ka arritur në Bagdad për të ndihmuar në vënien e sigurisë në qytet, si

e para në përforcimet e planifikuara prej gjithsejtë 21 500 ushtarëve. Ushtarët shtesë kanë arritur në momentin e dy eksplodimeve në Bagdad. Në njërin prej tyre, në eksplodimin e një minibusi në lagjen kryesisht shiite Karadi, kanë humbur jetën 6 persona. Bomba e dytë ka eksploduar në qendër të Bagdadit.

Në qytetin Basra në jug të Irakut, një ushtar britanik ka humbur jetën në eksplodimin e bombës së vënë pranë rrugës. Përndryshe, e shtuna ka qenë njëra prej ditëve më të vështira për ushtrinë amerikane që nga invizioni në Irakut në vitin 2003, atë ditë kur kanë vdekur afër 20 ushtarë amerikanë.



TURQIA E TRONDITUR



Shtypi turk reagoi ndaj atentatit në gazetarin dhe liderin e komunitetit armen, Hrant Dink

STAMBOLL, TURQI — Shtypi turk shprehu ndjenjën kombëtare të shokut, turpit dhe vetë-reflektimit të shtunën në lidhje me vrasjen e gazetarit dhe liderit të komunitetit armen, Hrant Dink, në hyrje të gazetës së tij dygjuhësore turko-armene

Vrasësi dhe motivi i vrasjes të së premtes ende janë të panjohura të shtunën paradite dhe ministri i Punëve të Brendshme, Abdulkadir Aksu, tha se nuk ka të dyshimet

të burgosur, Guvernatori i Stambollit tha, sidoqoftë, se autoritetet posedojnë fakte të cilat do t'i lejojnë ata për ta zgjidhur rastin.

Dink, 52, i cili u bë famëqëq pasi që ishte gykuar për thënie se vrasjet masive të armenëve në fillim të shekullit 20 kanë qenë gjenocid, është shtënë në të dhe është vrasëri të premten në pikë të ditës. Ai kishte pranuar kërcënime të panumërta para vrasjes së tij dhe kishte shkruar kolumnen e fundit

në gazetën e tij se ai ishte aq shumë i brengosur në lidhje me sulmet dhe koka e tij rrotullohej si pëllumb lëvizës derisa ai lëvizte rreth Stambollit

Shumë gazeta turke shfaqën fotografinë për të cilën thuhet se është vrasësi, një njeri me palltë dhe i kapur nga kamera e sigurisë e dyqanit nga prapa. Por, imazhi zbuloi pak detale për paraqitjen e njeriut.

Shtypi turk ishte unanim të shtunën në mëngjes në pohimet

si për njeri të vetin, jeta e të cilit në Turqi ishte e definuar si tradhtar dhe armik i vendit të tij.

"Hrant Dink është Turqi," ishte titulli në Milliyet.

"Vrasësi është tradhtar i kombit," thoshte Hurriyet.

"Tradhtia më e madhe," Gazeta Sabah.

Zyrtarët turq prematuan për t'i ekspozuar detajet e vrasjes, ndërsa kryeministri Rexhep Tayip Erdogan shkoi në televizionin kombëtar së paku tri herë për të folur për vrasjen.

"Plumbat e drejtuar në Hrant Dink-un ishin e shtënë në të gjithë neve," tha ai të shtunën. Brenda disa orëve të vrasjes së Dinkut,

kryeministri kishte dërguar ministrin e tij të Punëve të Brendshme dhe ministrin e Drejtësisë në Stamboll për t'i udhëhequr hetimet. Ata mbetën atje të shtunën.

Agjencia shtetërore Anatolia News Agency, raportoi se shefi policor i Stambollit dhe shefat e tjerë të njësisve kaluan natën në zyrën qendrore të policisë.

Shumica e turqve supozojnë se të shtënëta ishin reaksioni i deklaratave publike të Dinkut se vrasja masive e armenëve në kohën afër Luftës I Botërore ishin gjenocid shtetëror. Nacionalistët i shohin këtë lloj deklaratash si ofendim ndaj nderit të turqve dhe kërcënim për unitet kombëtar.

Arté

REDAKTOR: Faton Raçi
E-MAIL: faton.raçi@gazetaexpress.com
TEL: 038 542 270 FAX: 038 542 270-2



Deep në dërdëllitjet indiane

Regjisorja indiane, Mira Nair, do ta bëjë regjin e filmit sipas romanit 'Shantaram', i cili flet për kriminelin dhe narkomanin australian në Indi, të cilin do ta luajë Johnny Deep. Nair u zgjodh si regjisorja pasi që Peter Wier refuzoi projektin shkaku i mospajtimeve me aktorin kryesor dhe stu-

dion 'Warner Bros', për mënyrën se si romani do duhej të përshtatej në ekran. Në 'Shantaram' të Gregory David Roberts, varësi i heroinës nga një burg arratiset në Indi dhe atje përmes krimeve dhe kontrabandës prapë gjen vetën në rolin e mjekut në dërdëllitjet e Mumbai.

Përndryshe, Mira Nair arriti famën me filmin 'Martesa Monsune'. Produksionin për këtë film do ta bëjnë kompania e Graham King dhe vetë aktori Deep, që së voni bleu të drejtat e romanit për jetën dhe vdekjen e agjentit të helmuar rus, Aleksandar Litvinenko.

ARTI NUK ESHTË PASQYRE

Me ekspozita me titullin "Arti nuk është pasqyrë po'osht çekiç" të tetë artistëve të rinj, fillon punën hapësira e re për komunikim bashkëkohor "Rizoma".

Alban Muja

alban.muja@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 21 JANAR — Me hapjen e ekspozitës "Arti nuk është pasqyrë po'osht çekiç 1", ekspozitë e tetë artistëve të rinj, sot (hënë) në ora 19:00 fillon punën hapësira e re për komunikim bashkëkohor "Rizoma".

Ky projekt që ka filluar që tre vite me emrin 'Missing Identity', i cili tashmë është në përfundim e sipër, sjell ekspozitën në një hapësirë të re, hapësirë që është vazhdimësi e disa prej aktivitetëve të Institutit për Arte Bashkëkohore "Exit" në Pejë, por duke futur edhe përmblajtje të reja.

Sipas udhëheqjes së hapësirës së re për komunikime bashkë-

hore "Rizoma" në këtë projekt do të futen edhe përmblajtje të reja përveç ekspozitave, si prezantime, ligjëratë, workshope, debate si dhe çdo gjë që në përmblajtje ka komunikimin bashkëkohor.

Derisa pjesëmarrës të ekspozitës do të jenë artistët Fitore Isufi-Koja, Vigan Nimani, Kader Muzaqi, Luan Bajraktari, Bekim Gillogu, Anita Baraku, Leonora Mehmeti dhe Fatmir Mustafa, të gjithë me nga një vepër arti të mediumeve të ndryshme.

"Në kuadër të projektit 'Missing Identity' përveç aktivitetëve të shumta në kuadër të cilat kanë qenë edhe kurset për artet bashkëkohore, është bërë edhe një kurs i avancuar, në të cilin është punuar intensivisht, në kohë prej 6 muajve", tregon Mehmet Behluli, njeri nga udhëheqësit e projektit.

Mehmet Behluli, tregon se ai bashkë me Shkëlzen Maliqin dhe Dren Maliqin kanë mbajtur një kurs të dendur në përmblajtje si dhe në metodat synuese që sipas tij ishte një eksperiencë interesante për ta si 'moderatorët' pak më ndryshe se si kanë bashkëpunuar më parë me artistë të rinj dhe studentë të artit.

"Këtë herë ishim të

përqendruar ma shumë në atë se si në realitet ndodh kalimi nga vepra artistike në projekt artistik, dhe sigurisht se ky kalim, kapërcim ose rirreshtim, nuk është i lehtë" tregon ai.



ARTI NUK OSHT PASQYRE
AI OSHT ÇEKIÇ 1

Thotë se lypet nga autori një vetëdijë krejtësisht tjetër, një qasje krejt tjetër fare, më e kompletuar se sa janë munduar ta përkrahin ma parë. "Mos të harrohet se aktiviteti artistik dallon nga aktivitetet e tjera të njeriut për kah mënyra se si ajo është thanë, e jo për kah mënyra se çka thuhet, ose që të dyjat së bashku", tregon.

Behluli mendon se edhe në botën e "qytetnueme", shpesh sot kur vjen deri të realizimi i projektit, estetika dhe materialet disi mbeten nën hijen e asaj se çka ka dashur të thotë artisti, e jo se si e ka thanë atë.

Thotë se ekspozita "A është arti pasqyrë apo është çekiç, a asht ma shumë pasqyrë apo është ma shumë çekiç, apo asht që të dyja në të njëjtën kohë, apo një mundësi e katërt, le ta shohim në të ardhmen" thotë ai.

Njeri nga mundësit do të jetë edhe ekspozita e tetë artistëve, të cilët në hapësirën

"Rizoma" do të na tregojnë qysh sot. "Rizoma" gjendet në rrugën Tringë Smajli nr. 34.

ÇKA ËSHTË RIZOMA

Konceptin e Rizomat e kanë zhvilluar J. Deleuze & P. Guattari në librin "Një mijë pllaja". Në botanikë rizoma (rhizome) emërton disa bimë me rrënjë specifike që mundësojnë riprodhimin vegetativ, nga vetvetja. Për Deleuze & Guattari rizomi bëhet metaforë e përmbyesjes së mendimit hierarkik. "Rizomi dallon nga rrënjët e pemës... Nuk duhet t'i besojmë më pemës. Kemi vuajtur shumë nga kjo. Pema lidhet me gjenealogjinë, kurse rizoma është anti-gjenealogjik." Struktura hierarkike e pemës ka dominuar shoqërinë perëndimore (p.sh. hierarkitë e korporatave, hierarkia e pushtetit, zinxhiri i komandës në armatë etj.). Të rizoma çdo pjesë e strukturës është e lidhur me të gjitha pjesët tjera, kështu që nuk ka fillim dhe mbarim, poshtë dhe lartë, gjithkund është fillim dhe qendër. Me këtë koncept nuk pranohet më ndarja në tresh mes realitetit (bota), reprezentimit (vepër arti) dhe subjektivit (autori). Koncepti i rizomat paraqet një sistem pa qendër, jo-hierarkik, që definohet vetëm si qarkullim i gjendjeve.

Kukumi në Amerikë

Filmi "Kukumi" do ta hapë festivalin "Spokane International Film Festival".

Si mysafirë të këtij festivali do të jenë edhe dy aktorët e këtij, Luan Jaha dhe Anisa Ismaili.

Milot Hasimja

milot.hasimja@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 21 JANAR — Filmi "Kukumi" i regjisorit Isa Qosja, që nga 25 janari e deri më 4 shkurt do të jetë mysafir në Amerikë. Filmi "Kukumi" do të jetë edhe filmi i hapjes së festivalit "Spokane International Film Festival". Sipas Burbuqe Berishës nga Kosova Film, producent i këtij filmi, "Kukumi" është ftuar me vetë kërkesën e këtij festivali pasi ishte parë ed-

he më herët në disa festivale.

"Me kërkesën e festivali ka ardhur ftesa pasi "Kukumini" e kanë parë në festivale tjera dhe u ka pëlqyer filmi, dhe kane vendosur që ta thërrasin dhe njëherë edhe ta hapë festivalin si filmi i parë që shfaqet", tha Berisha për Express. Së bashku me filmin do të shkojnë edhe aktorët kryesorë të këtij filmi si Luan Jaha dhe Anisa Ismaili.

"Ne si aktorë që po udhëtojmë në Amerikë është një ndjenjë shumë e mirë sepse është me rëndësi, sepse festivali po hapet me këtë film, atëherë pra-


nia e ime dhe e Luanit e bën edhe më madhështorë", tha aktorja Anisa Ismaili.

Spokane International Film Festival është një festival jo aq i madh i cili tashmë po hyn në vitin e 9-të të jetës së tij. Sipas asaj që thuhet në faqen zyrtare, ky festival mbledh filma të klasës botërore. Filmat si dokumentarët që do të prezantohen në këtë festival janë ata të cilët nuk janë më të vjetër se dy vjet dhe që audienca e gjerë nuk ka pasur mundësi t'i shohë. Në fakt filmat që do të

prezantohen në këtë festival janë po të njëjtit filma të cilët janë prezantuar më parë në festivale,



si ai i Cannes, New York ose Toronto Film Festival. Atraksioni më i madh i këtij festivali, siç thuhet, është prezenca e filmmaxhinjve dhe vetë aktorëve kryesorë të filmave. Andaj aktorët si Luan Jaha dhe Anisa Ismaili, që do ta përfaqësojnë filmin në këtë festival, do të qëndrojnë edhe para pyetjeve të shumta që do të vinë nga audienca.



Greengrass me projekt të ri

Regjisori britanik Paul Greengrass, autor i të lavdishmit "United 93", paralajmëroi projektin e tij të ri. Fjala është për dramën dokumentare e cila do portretizojë Irakun pas invazionit amerikan. Sipas magazinës filmike "Variety", për këtë film,


Greengrass planifikon përshatjen nga libri i Rajiv Chandrasekaran "Jeta Carike në qytetin Smaragd: Brenda zonës së gjelbër irakiane". Chandrasekaran ishte korrespondenti kryesor i "Washington Post" gjatë kohës së sulmit në Irak. Megjithatë,

filmi i fundit i Greengrass "United 93" u lavdërua shkaku i paraqitjeve reale të ngjarjes në aeroplan që u shfrytëzua me rastin e sulmit në WTC. Në mënyrë që sa më sinqerisht t'i rindërtojë ngjarjet brenda aeroplanit, Greengrass përdori radio-shkrimet dhe thirrjet

telefonike nga aeroplani të shënuara më 11 shtator. Nismën e ekranizimit të këtij projekti me luftë në Irak, Greengrass do ta fillojë pasi ta mbarojë xhirimin e "Bourne Ultimatum", film ky i treti me radhë për super-spiunin Jason Bourne.

Kolegët e tij të letrave e përkujtuan Rugovën me një tribunë letrare, në të cilën u fol për kontributin e tij dhënë letërsisë shqipe.

Rugova i letërsisë



Rugova i letërsisë

Alfred Beka

alfred.beka@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 21 JANAR —

Nuk mund të flitet për Rugovën e të mos përmendet letërsia dhe krijimtaria e tij letrare. Para se të bëhej i njohur si politikan, Ibrahim Rugova kishte shkruar një mori librash nga fusha e letërsisë dhe studimeve letrare, me ç'rast ka lenë gjurmë të pashlyeshme në studimin e letërsisë shqipe. Për të përkujtuar kontributin e tij dhënë letërsisë, dje në një vje-

torin e vdekjes së tij, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, u mbajt tribuna letrare "Rugova i letërsisë" në të cilën referuan Sabri Hamiti, Kujtim Shala dhe Vehbi Miftari.

Sabri Hamiti, deputet dhe kritik letrar, tha se nuk flet për Rugovën si një parlamentar, por si një mik i tij dhe si studiues. "Duhet të flitet për Ibrahimin në radhë të parë, pastaj për Ibrahim Rugovën, e me pas për Rugovën. Sepse fillimisht e kemi thirrur gjithnjë Ibrahim, kur ai mblodhi myshkun e malit për të blerë libra, preu drurin e malit


për të bërë libra, se kishte ngritur kultin e dijes dhe libri mbeti gjithmonë burimi i dijes së tij", tha Sabri Hamiti. Ai tregoi se Ibrahim Rugova ka nisur krijimin letrar me lirika meditative, kurse shkrimin kritik me një portret për Ismail Qemalin. Hamiti tha se Rugova e ka njohur e dashur prozën e Dostojevskit, pastaj poezinë e Bodlerit, e prozën e Prustit, të Kafkës e në fund Xhejms Xhojsin. "Sa për letërsinë shqipe, ajo është djepi në të cilin është rritur, një herë duke e lexuar me dashuri, herën tjetër duke e studiuar me përkushtim", u shpreh Hamiti.

Ndërkaq, Kujtim Shala u shpreh se Ibrahim Rugova e ka nisur jetën letrare si krijues dhe e ka vazhduar si rikrijues dhe e ka mbyllur si klasifikues, apo sistematizues. "Ky përgjithësim u referohet shenjave themelore të diskursit të Rugovës, së pari fikcioni, së dyti diskursi i hapur, së fundi diskursi konceptual", tha Shala.

Duke folur për idealitetin dhe vizionaritetin e Rugovës, Vehbi Miftari tha se idealiteti i Rugovës nis si idealistat kulturor brenda qarkut kulturor të Prishtinës, i cili lidhet me emra të shquar të kulturës e të letrave dhe kapërcen në idealitetin politik të fundviteve tetëdhjetë, i cili është po kështu produkt i këtij qarku. "Studimi i veprës së Pjetër Bogdanit e shndërroi përmasën e idealeve në vizionin e Rugovës për të tashmen e të ardhmen e shqiptarëve, kurse figura e tij shkencore e letrare që udhërrëfyes intelektual për të njohur dhe për të përdorur vlerat e mirëfillta kulturore nacionale në shërbim të krijimit të një platforme politike", tha Miftari. Sipas tij, Rugova e lexonte shumëfish sfidën e antikitetit, besonte në traditën e popullit të vet dhe e ndërtonte modernitetin e tij përmes rikrijimit të shenjave nacionale.

VDIQ PA

Dizajnet dhe kuptimet e kopertinave të albumeve muzikore të kopertinës së albumit të 'Sgt. Pepper's Lonely Hearts'



Vdekja fizike e këngëtarëve më të njohur botërorë shumë shpesh ka ditur të kundërshtojë nga ana e adhuruesve të tyre. Në mesin e adhuruesve të Elvis Presley dhe Jim Morrison edhe sot e kësaj ka të atillë që do t'ju thonë haptas se ata besojnë që idhujt e tyre janë

ende gjallë, por edhe se vdekja e tyre, në të vërtetë është trilluar për shkak të qëllimeve të ndryshme dhe shumë më të rëndësishme. Ndoshta?

Mirëpo, çka të thuhet kur të pohohet se njëri nga muzicentët më të njohur botërorë, i cili njëherësh

Nesër prej orës 19:30, në teatrin "Dodona" në Prishtinë do të jepet premiera e shfaqjes "Burrat e dëshpëruar", në regji të Elmaze Nurajt, me tekst të Alto De Benedettit. Në rolet kryesore paraqiten aktorët Edona Reshitaj, Armend Baloku dhe Besart Sllamniku.

Janë shitur 675 milion këngë përmes internetit

Viti 2006 fitoi edhe një atribut muzikor. Gjegjësisht vitin e kaluar përmes internetit në tërë botën janë shitur më shumë se 675 milion këngë, siç raporton 'Nielsen SoundScan International'. Vetëm në tregun e Amerikës Veriore janë kryer pothuajse 600 milion shkarkime.

Bruce Willis përsëri "vdes si burrë"

Për kënaqësinë e adhurueseve, Bruce Willis përsëri do të vesh fanellën e shqyer me njolla gjaku, në filmin e radhës 'Die Hard 4'. Willis iu kthye rolit të John McLain, i cili e bëri të famshëm para 19 vjetësh. Në pjesën e katërt të serialit, sulmi mbi infrastrukturën e brishtë kompjuterike

amerikane fillon të shuaj kombin. Personi misterioz që qëndron pas këtij plani ka planifikuar çdo detaj digjital – megjithëse nuk ka llogaritur në agjentin e prapabetur "analog", John McLain. Përveç Bruce Willis, në film luajnë edhe Justin Long, Meggy Q. Timothy Oliphant dhe Mery

Elizabeth Winstead. Regjinë e filmit do ta bëjë Lean Wyman, i njohur edhe nga seriali filmik 'Underworld'. Tri pjesët e para të 'Die Hard' inkasuan mbiu 740 milionë dollarë, ndërsa pjesa e katërt, 'Live Free or Die Hard', në kinematë amerikane do të paraqitet më 28 qershor.



PAUL! RROFTE PAUL!

re gjithnjë kanë zgjuar kureshtjen e blerësve të tyre. Rrëfimi në vazhdim është vetëm një përpjekje për shpjegimin e kuptimit 'Club Band', të The Beatles. Shpjegimi i kuptimit të dizajnit të kopertinës së tij enigmatike gjithsesi se është ndër më interesantët...



pjesëtarëve shumë më herët se sa kur në dhjetorin e vitit 1980 Mark Chapman vrau John Lennon. E tëra filloi më 12 tetor të vitit 1969, kur Russ Gibb, përndryshe një DJ i radio-stacionit 'WKNR-Fm' nga Detroit, pranoi një thirrje të çuditshme telefonike nga personi që u prezantua si "TOM", i cili pohonte se disa nga albumet e bendit përmbajnë gjurmë të fshehta, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë sugjerojnë për vdekjen e Paul McCartney. Por, çfarë në të vërtetë ishte ajo që ndodhi në "botën paralele?"

Teoria e Komplotit

Posa doli nga studioja, më 9 nëntor të vitit 1966, Paul u ul brenda veturës së tij të bardhë sportive 'Aston Martin' dhe, megjëse nuk kishte vënë re dritat e semaforit, po atë të mërkurë rreth orës 5 të mëngjesit kishte bërë ndeshje, të cilën nuk e kishte mbijetuar për shkak të plagëve të rënda të kokës (thuhet se kishte dalë nga rruga dhe kishte rënë në fund të një greminë). Në një version tjetër të rrëfimit përmendet një auto-stopere (Rita), shkaku i lëvizjeve të kokës së të cilës gjatë vozitjes, Paul McCartney edhe fjalëpërfjalshëm e kishte humbur kokën.

Detajet e fatkeqësisë kurrë nuk u publikuan për opinionin, ngase në atë moment asnjë nuk i përgjigjej përfundimi i beatlemania's. Rrjedhimisht, pastaj u mbajt një garë për zëvendësin, gjegjësisht "kopjen", e Paul, fituesi i së cilës kurrë nuk u bë i ditur publikisht. E fituesi, i cili u zgjodh në fshehtësi të madhe ishte njëfarë William Campbell, një aktor kanadez me një fytyrë pothuaj skajshmërisht të ngjashme me atë të të vdekurit. Imtësisht e vogla (hunda dhe mjekra) iu korrigjuan përmes operacionit plastik, megjithëse William kishte një vërragë mbi buzën e epërme e cila asesi nuk mund të hiqej, vërragë kjo që edhe mbeti si shenjë daluese mes Paul dhe "kopjes" së tij.

Epo, 'show' duhej vazhduar...

Natyrisht, dihet edhe ajo se pikërisht në vitin 1966 The Beatles hoqën dorë nga turneu i para-

parë, me gjasë për shkak të asaj se "kopja" e Paul ende nuk ishte e gatshme, kështu që, ai si i tillë do të mund të zbulohet shpejtë. Ajo që është edhe më interesant është fakti që pjesëtarët e bendit po atë vit vendosën që të ndryshonin imazhin e tyre: Ata lëshuan mjekra, ashtu që inaugurimi i "kopjes" së Paul (meqë mjekra dhe mustaqet në mënyrë të përkryer mbulonin vërragë diskutabile) të kalonte sa më pavërejtshëm dhe pa ndonjë publicitet negativ.

Dhe, përkundër asaj që "kopja" e Paul fshihej pas mjekrës dhe mustaqeve, duket se Lennon, Harrison dhe Starr i brente ndërgjegjja, prandaj ata, në kopertinat e pllakave, por edhe nëpër tekstet e këngëve të tyre, sistematikisht e bindnin publikun në atë që publikisht kurrë nuk kishin gjuar të pranonin.

E para, e njëkohësisht edhe gjurma më e qartë për këtë është kopertina antologjike e albumit 'Sgt. Pepper's Lonely Hearts Club Band', albumit të parë të xhiruar pas fatkeqësisë së Paul, i cili u publikua në vitin 1967. Në kopertina shihen pjesëtarët e bendit, të veshur në uniforma të ngjashme me ato të ushtarakëve, se si qëndrojnë para një timpani në të cilin shkruan emri i albumit. Ndërkohe, ata janë të rrethuar me përplot fytyra të njohura.

Ndërkaq, për sa u përket gjurmëve dhe porosive, ato lehtas mund të gjenden me një analizimin të vëmendshëm të kopertinës së albumit (natyrisht, nëse e keni, ose nëse mund ta siguroni dikuj).

Kopertina

Në skajin e djathtë të albumit, me lule të verdha, dhe menjëherë mbi emrin e bendit, është formuar një formë e bas-kitarës, e cila, sikurse e dimë, është instrumenti i Paul. Megjithatë, edhe pse bas-kitarë i ka katër tela, kjo i ka vetëm tre, një referencë kjo për numrin e pjesëtarëve të gjallë. Pastaj, po këto lule të verdha formojnë fjalën "PAUL?", duke vënë kështu në pikëpyetje ekzistimin e Paul.

E tani, përqendrohuni në kukullën, nga ana e djathtë, të veshur në një fanellë me vija dhe me mbishkrimin 'Welcome The Rolling Stones'. Modeli i veturës lodër që ajo mbanë në dorë është identik me atë në të cilin vdiq Paul McCartney (vetura është drejtuar kah fjala 'Stones', e shkruar si me gjak), ndërsa për kukulle pastaj qëndron mbështetur një dorëzë vozitësisë. Tutje, në këmbën e majtë të kukullës, ndodhet një vazë e bardhë me lule të verdha, pra edhe një asociim për veturën e bardhë dhe me pjesën e pasme të kaplaur nga zjarri se si bije poshtë greminës.

Nën shkronjën T, në emrin e bendit, qëndron një figurë e vogël e 'Shiva', Zotit hindus të vdekjes (edhe pse 'Shiva' s'mund të përkryhet aq lehtë, andaj këtë "Zot të vdekjes" duhet marrë me rezervë), dora e të cilit është e drejtuar drejt kah Paul. E, meqë veç u prek çështja e religjionit, shuplaka e hapur mbi kokën e dikujt në disa kultura simbolizon vdekjen – e shuplaka e hapur e komikut Issy Bon qëndron pikërisht mbi kokën e Paul.

Përqendroni vëmendjen edhe në vetë pjesëtarët e bendit, a nuk duket Paul McCartney disi si dy-dimensionalisht krahasuar me të tjerët? Disi sikur të jetë bërë nga kartoni? Dhe, përse vetëm ai mban një instrument të zi në dorë?

Epo, nëse e gjithë kjo nuk mjafton, atëherë provoni edhe këtë:

Merrni një pasqyrë dhe vendoseni horizontalisht nëpërmes të timpanit, saktësisht nëpërmes të fjalës 'LONELY HEARTS', në mënyrë që në të pasqyrohet gjysma e sipërme e timpanit – pra ajo ku shkruan 'PEPPERS'. Nëse e bashkoni tekstin e kopertinës me atë që shihet në pasqyrë do të fitoni këtë tekst: I ONE IX HE DIE... 'I ONE IX', e 11/9 është data e vdekjes së Paul (9 nëntor), sikurse edhe tregon pjesa tjetër e titullit ('HE DIE'). Mes këtyre dy fjalëve është edhe shigjeta, e cila është e drejtuar pikërisht kah Paul.

VAZHDON NË NUMRIN E NESËRM

është edhe pjesëtar i një prej vendeve më të mëdha dhe më të rëndësishme të të gjitha kohërave, në të vërtetë është i vdekur tash e 40 vjet? Bendi quhej "The Beatles, dhe ai zyrtarisht ishte shpërndarë në prillin e vitit 1970, ndërsa ai, Paul McCartney, atëbotë

kishte mbushur katër vjet qyshkur kishte vdekur!

Thirrja anonime

Njëra nga teoritë më të vjetra të komplotit brenda pop skenës muzikore botërore pohon se The Beatles kishte humbur njërin prej

**Robbie Williams zhvishet për Elton John**

Pop këngëtarja kontrovers Robbie Williams do të dhuron mikut të tij Elton John për ditëlindje të 60-ri, të cilin do të përformojë në kremen e ditëlindjes, raporton "Daily Star". Këngëtarja vendosi që ta përformojë skenën e zhvishjes nga filmi "The

Full Monty" në kremen e cila do mbahet në New York "Madison Squer Garden" me 25 mars, ndërsa si kulmi i mbërmysjes parashihet të jetë striptizi i Robbie, me këngën "You Can Leave Your Hat On". "Elton dhe Robbie kanë pasur shumë keqkuptime

gjatë viteve që kaluan, por tash janë prapë miq më të mirë", lajmëroi një burim. "Atyre iu pëlqen të përgatisin surpriza dhe të befasojnë njëri tjetrin, kështu që për ditëlindjen e Robbie muajin e ardhshëm Elton do të përgatit diçka bizare", tha miku i tyre i përbashkët.

**Epakënaqura
Patti Smith**

Punk-këngëtarja e dikurshme Patti Smith është e zhgënjyer me yjet e sotme të skenës muzikore, sepse ato nuk po tregojnë kurrfarë interesimi për politikë e as nuk janë në gjendje të ngrehin zërin kundër Luftës në Irak, për ndryshim nga aktorët hollivudianë gjithnjë e më të pranishëm. Patti në orbitë e hodhi punk-lëvizja e viteve të shtatëdhjeta. Albumi i saj i parë "Horses" u pranua shkëlqyeshëm dhe falë tij ajo fitoi statusin e punk-poetes dhe këngëtares më të mirë.


Në këtë stil muzikor, ajo e para futi sadopak intelektualizëm, megjithatë ishte një feministe e njohur, gjë që edhe i ndihmoi të gëzojë statusin e këngëtares më me ndikim. Shikuar komercialisht, suksesi i saj ishte edhe aq i madh, por gjurmët e saj në botën e muzikës i sollën një kult-status, po ashtu edhe një vend në "Rock and Roll Hall of Fame".

Ajo edhe sot është angazhuar rreth disa çështjeve kyçe politike në SHBA. Kështu, ajo angazhohet aktivisht kundër politikës së kryetarit Bush në Irak, së bashku me kandidatin presidencial amerikan nga viti 2000, Ralph Nader.

Smith mendon se tani është koha e duhur për marrjen e qëndrimeve të qarta politike, andaj edhe i pengon mangësia e vetëdijes politike dhe qytetare e këngëtarëve të sotëm. "Këngëtarët, shkrimtarët, artistët, poetët, të gjithë janë distancuar nga lufta, gjë që për mua është dëshpëruese", theksoi Smith. "Nuk e kuptoj. Ishin vetëm pak njerëz, sikur Susan Sontag dhe Steve Earl që ndërmorën diçka, por të këllët mund t'i numërosh në gishta", shtoi ajo.

**STALLONE EKTRANIZON
GJENOCIDIN ARMEN?**

Pasi xhiron vazhdimin e fundit të 'Rocky', i patremburi Stallone vendosi ta xhironjë filmin për gjenocidin armen, të cilin kryesja e tij, Turqia, e mohon tashmë 85 vjet.



Sylvester Stallone, i cili me vazhdimin e gjashtë mbylli sagën për boksierin e famshëm Rocky Balboa, hidhet në projekte të reja. Këtë herë u interesua për tregimin mbi gjenocidin armen dhe po përgatitet, siç thotë edhe vetë, "ta xhironjë epin për shkatërrimin total të një civilizimi". Skenari do punohet sipas librit kontrovers të austriakut Franz Werfel "The Forty Days Os Musa Dagh", që flet për gjenocidin të cilin qeveria turke gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore bëri ndaj popullatës armene. Numri i viktimave sille rreth 650 000 deri në 1,5 milionë.

Armenet 30 vite luftuan që vrasjet masive në periudhën prej 1915 deri 1917 të shpallën si gjenocid, por qeveria turke këto ngjarje i mohon edhe sot.

Udhëheqësit e organizatës "Association On Struggle Against Armenian Genocide" përqipen ta bërë Stallone të heqë dorë nga ky projekt.

"Ai libër është përplot gënjeshtër, sepse autori ato informata i mori nga nacionalistët dhe radikalët armenë. Ne tashmë i dërguam dokumente të duhura me statistika të saktë producentit. Aleatët tanë do lobojnë të ai që mos ta bëjë produksionin e filmit", tha prijësi i organizatës Savas Egilmez.

Është mjaft interesante që shkaku i deklaratur se Mbretëria Otomane në fillim të shekullit XX kreu gjenocid ndaj miliona armenëve dhe 30 mijë kurdë, u gjykoa edhe fituesi i çmimit Nobel, Orhan Pamuk, por shkaku i shtypjes së bashkësisë ndërkomëtare ky proces u ndërpre.

Arsyetimi ishte që shkrimtari "ofendoi identitetin turk" në mars të 2005, para vënies në fuqi të ligjit të ri dhe Ministria e Drejtësisë vërtetoi që nuk mund ta ndjekin për atë. Shpresojmë që Rambo edhe këtë herë e din në çka po futet.

HOROSKOPI**DASHI (21/III-19/IV)**

Situata juaj astrologjike për mërisohet mjaft në fundjavë. Dielli del nga pozicioni i disfavorshëm për t'ju dhënë ide të mrekullshme si në profesion, ashtu edhe në studime. Në jetën private do të keni një idealizëm që do ju bëjë të keni mjaft avantazhe.

**DEMI (20/IV-20/V)**

Dita e sotme nuk sjell të reja të mëdha. Duke nisur që sot duhet të përqipet shumë për të kuptuar çfarë doni të bëni me jetën tuaj, përndryshe mund të bëni gabime të mëdha. Bëni plane dhe programoni gjithçka për të mos e humbur orientimin e duhur.

**BINJAKET (21/V-21/VI)**

Sot ndiheni plot energji. Gjithçka që do bëni do ju duket e mrekullshme të tjerëve. Keni shumë qëllime të mira dhe do arrini t'i ktheni ato në gjëra konkrete që do i vlerësojnë të gjithë herët a vonë.

**GAFORRJA (22/VI-22/VII)**

Hëna del nga pozicioni i disfavorshëm dhe ju largon atë sjelljen antipatike që nuk ju përshatet aspak. Me disa familja rëndim të bëhen diskutime interesante, disa prej të cilave mund t'ju bëjnë të mendoni edhe për biznese interesante.

**LUANI (23/VI-22/VII)**

Fundjava ju gjen me Diellin në pozicion të disfavorshëm. Nuk do keni energji të mjaftueshme për të realizuar diçka konkrete. Do jeni të pavendosur. Nëse keni ndër mend të bëni diçka për vetë, duhet të dini të tregoni se qëllimet tuaja janë serioze.

**VIRGJERESHA (23/VII-22/VIII)**

Aftësia për të përballoar problemet e përditshme është rritur mjaft me hyrjen e Hënës në shenjën tuaj. Do jeni konkretë në veprimet tuaja, gjë që do vihet re nga shefat tuaj, të cilët do kuptojnë se aspironi për diçka më shumë.

**PESHORJA (23/VIII-22/IX)**

Lëvizja e diellit do të përmirësojë më në fund humorin tuaj. Do jeni shumë më origjinalë sesa javët e kaluara. Personat me të cilët do bashkëpunoni, do mendojnë që meritoni diçka më shumë. Seksi i kundërt do jetë mjaft i intriguar nga sjellja juaj.

**AKREPI (23/X-21/XI)**

Edhe pse shumë njerëz do mendojnë që nuk jeni seriozë dhe ndryshoni shpesh ide, kjo nuk do të thotë që nuk do e rimerrni veten. Para se të flisni, bëni një refleksion të gjatë dhe flisni vetëm nëse jeni shumë të bindur për atë që doni të thoni.

**SHIGJETARI (22/X-21/XII)**

Që sot do të keni fantazi dhe intuite të madhe. Do të jeni nën influencën e Jupiterit që formon një kuadrat të bukur me shenjën tuaj. Personi që ju ka rëmbryer zemrën do të ndihet shumë i kënaqur nga vështrimet tuaja intrigante.

**BRICJAPI (22/XII-19/III)**

Planeti i dashurisë braktis shenjën tuaj. Tani duhet të nxirni në pah të gjitha njohtet dhe flitret që kanë lindur javët e fundit. Në ofitë se jeni në kërkim të shpirtit binjak, kështu është momenti i duhur për njohtet e reja.

**UJORI (20/I-18/II)**

Planeti i argëtimit hyn sot në shenjën tuaj. Do të jetë një ditë e jashtëzakonshme. Do të dini si të silleni për të argëtuar personat që ju pëlqejnë më shumë. Si të mos mjaftonte do të argëtohemi shumë në fushën sentimentale me atë që doni ju.

**PESHQIT (19/II-20/III)**

Edhe pse kjo këshillë ju duket e pavlerë, ju duhet të shkoni përtej ndjenjave. Në realitet një arsye për të insistuar është se Jupiteri hyn në elementin tuaj dhe ju bën të jenë në qendër të vëmendjes për sa u përket ndjenjave.

CITATI I DITËS


"Unë besoj se në një qytet të madh, në një të vogël, ose edhe në një fshat, teatri i madh paraqet një shenjë të jashtme dhe të qartë të një kulture të mundshme të brendshme".

Sir Laurence Olivier - aktor britanik (1907-1989)

SHUMË TË HOLLASH SI PARADHËNIE (shq.)			BARI, MEDIKAMENTI	DREJTUESI I AEROPLANIT	INTRO	FRANCE	SUNAJ RAÇA	LLOJ SHEQERKASH	BANORI VENDESI I KANADASE	DESPOTI SUNDIMTARI	PËRËMËR PRONOR	SHTRESA E HOLLE E BRUMIT	GJITHASHTU (lat.)	FOSFOR	ERMIRA MORINA		ANËSIMË
BIME BARISHTORE SHUMËVËJÇ.			AKTORJA, TOSKA			BASKETBOLL AMERIKAN NGA FOTO ARTIOLA TOSKA											PA DOBI
LODËR FËMUJËSH (shq.)					LËVRIMET												
SHPORTË (sh.shq.)					REGJISORI SHQIPTAR, GËZIM										SHOK, JARAN		
							RRALLËSI (lat.)									MOLIBDEN	
							I FRYTSHËM, I ...									AZOT	
EMËR MASHKULLI						KËNGËTARJA SHQIPTARE, GJERGJI						POROSI E FUNDIT					
						RADIUS						TË BËRIT SI TJETRI					
ITALIA		AI QË DEHET ME ETER (shq.)															
		PERSIA															
Autor ARMAN AGUSHI	INTENSITET		ILIR BERANI			KOMIKU YNË DINA											
	PJESË E DERËS, PENGESË		ANGSTREM			QYTET NË J TË ISHULLIT HONSHU											
NË ATË RAST (ndajf.)				I PARI PLANET I VOGËL													
				PËRËMËR VETOR													
RADIUM			ARIU														
			Ë.G														
AI QË BËN PJESË NË NJË ORGANIZATË, PARTI etj																	
VEGËL MUZIKORE ME HARK						PËRHAPJE E VALEVE											



E HENE	E MARTE	E MERKURE	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNE
PRISHTINA					
Mot me re dhe diell. Temp. 7° C. 2° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 9° C. 2° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 11° C. 3° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 11° C. 2° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 9° C. 2° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 10° C. 1° C.
PRIZRENI					
Mot me re dhe diell. Temp. 10° C. 5° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 14° C. 6° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 13° C. 6° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 13° C. 7° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 10° C. 1° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 12° C. 1° C.
PEJA					
Mot me re dhe shi. Temp. 14° C. 3° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 8° C. 5° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 14° C. 7° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 13° C. 6° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 13° C. 6° C.	Mot me re dhe diell. Temp. 11° C. 2° C.



Gjendja e atmosferës në vendin tonë
Vendi ynë do të jete nën ndikimin e veprimit të sistemit frontal të masave ajrore me veti të ndryshme fizike

Moti
Për rrjedhojë moti do të jetë me vranësira të cilat në orët e vona të ditës kanë mundësi që të përcjellën me riga lokale shiu

Temperaturat
Temperatura minimale do të luhatët nga (6) deri në (7) gradë celsius, maksimalja, nga (7) deri në (10) grade celsius

Shtypja atmosferike
Shtypja atmosferike 945 deri në 958 milibar

Lagështia relative e ajrit
Lagështia relative e ajrit në mëngjes 95%, gjatë ditës do të zbris në 68%

Dukshmëria horizontale
Dukshmëria horizontale nga 1 deri në 13 kilometra

Era
Do të këtë erë nga ana e jugut dhe juglindjes me shpejtësi 1 deri në 8 metra në sekondë




07:00 Programi i mëngjesit **09:30** Top Shop **10:00** Lajmet Radio Kosova **10:05** Programi arsimor **11:00** Lajmet Radio Kosova **11:05** Programi për fëmijë **12:00** Teen r **12:35** Videoklipe **12:50** Top Shop **13:00** Lajmet Radio Blue Sky **13:05** Fama r **13:30** Telekino r **14:00** Lajmet Radio Blue Sky- në gjuhën serbe **14:05** Pro et contra r **14:35** TMK **15:00** Lajme **15:05** Medika **15:30** Top Shop **16:00** Programi arsimor **16:55** Top Shop **17:00** INFO **17:10** LAJME- Për personat e shurdhër **17:15** VESTI - Për personat e shurdhër **17:20** MOSTOVI **18:20** HABER **18:35** Telekuizi **18:45** Njëpër Kosovë **19:00** VESTI **19:10** Film vizatimor **19:20** Marketing **19:30** LAJMET

20:05 Sport Plus **22:15** Program muzikor
20:10 Loto **22:50** Top Shop
20:20 Debat: Jeta në Kosovë **23:00** BLIC
21:45 Aktualitete **23:15** Melrose Pl.



Të premtën në orën 15.05 minuta mund ta ndiqni emisionin "Medika". Ky emision merret me problemet e mjekësisë, para së gjithash të asaj familjare. Realizohet në eksterier, dhe ka karakter edukativ dhe këshillëdhënës, gjithomë nga ekspertë të mjekësisë. Emisioni udhëhiqet nga Shukrane Qyqalla, dhe zgjat 25 minuta.

00:00 Lajme **00:05** Videoklipe **00:30** Zëri i Amerikës në gjuhë serbe **00:45** Film artistik **02:45** Debat: Jeta në Kosovë r **04:10** Aktualitete r **04:40** Amazing be njeri r **05:20** Fama r **05:50** Videoklipe **06:00** Zëri ynë r **06:30** Serial: Melrose Place r **07:20** Videoklipe **07:30** Medika r **08:00** Programi i mëngjesit

	Express	IAKADEMISË	SOLISTJA E NJOHUR OREIRO	FJALË E RENDË, E PAHJUSHME	RENDI, KLASA (sport)	I BËN MERAK (lokal.)	PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT	GRUP KËNGËTARËSH (shq.) USHQEHEM	ENERGJIA	SOLISTE E NJOHUR BOTËRORE
	ZBËRTHEHET									
	MIRËMËNGJES (gr) NJË LLOJ SHPATE (shq.)								ANGSTREM LLOJ USHQIMI NGA BRUMI (sh.shq.)	
	▶								KASUMI NAKANE ROMANCIER FRANCEZ, ZOLA (shq.)	
	RREMB (shq.) TRANS-METUES								ASTRONOM ANG., XHORXH BIDEL NJË PASTHIRRMË	
	▶					GRIMCAT E IMËTA AKTORJA SHQIPTARE NGA FOTO				
	QË LIDHET ME MITIN								MAL NË JP TË BULLGARISË VEGËL MUZIKORE	
	ISABELLE ADJANI					TREGIMET E GJATA QË VUAN NGA MANIA				
	KELVIN DJALË I TEZES					MODELJA MASHKULLI I MACËS			LUMË NË AUSTRI BREJTËS GJITAR	
	AKTOR I NJOHUR AMERIKAN	▶	PËRUROJ	NAOMI KAMPBEL	CIGARJA	TEMPO TRI ZANORE	ARTIKULL GRAMATIKOR I GJERMANISHTES DREJTËZAT		NJËSI E REZISTENCËS ELEKTRIKE E N	
MANEKINE E NJOHUR AMERIKANE										
TERROR (shq.)									ZANORJA E PESTË	REZISTENCA LLOJ MINERALI
NATRIUM			HUAZOJ PUNËTORËT QË PUNONIN PA SHËRBBIM			ALEN NURI ZGJUAR		MARKË TELEFONASH I HOLLË E I BRISHTË		
HUMORISTI YNË, ZENEL GJIGANTI					KAÇAK I FILLOVE				"ARMENE" NJË KONTINENT	
▶					EMËR I HUAJ MASHKULLI JO PROFE-SIONISTI		ZANORJA E PARË THIRRJE TELEFONIKE	VEND NË ISHULLIN SHIKOKU NË JAPONI I TË		TË BËRIT SITJETRI (shq.)
GYP METALI, QË PËRDORET PËR TË ÇUAR UJË						"ARGËTIMI" OLIVER TUIST	KENDI QË FORMOHET NË PIKËN E VROJTIMIT LLOJ PAPANALLI			
TRUNG			PANDER-SHMËRI SKITARI TAJLANDEZ, OLIVER							METRI PIKË-PJEKJE
VONIMET						ITHTAR I ROKUT FRED ASTAIRE			TITAN GRUP ISHUJSH ISLANDEZ	
LAGET ME UJË, SIPËRFAQJA E TOKËS						NOTË SOLMIZIMI VETURË E FABRIKËS MINSKUT		EAST EMËR I HUAJ MASHKULLI	ZEMËRIM, ZILI "ASSOCIATED PRESS OF INDIA"	
GJERMANIA		KETRIN OKSENBERG DONA AIR		AKTORI EGJIPTIAN, SHARIF (shq.) O.L				GUR I KUQ GJYSEM I ÇMUAR AGIM RAMADANI		
Express	BORA KALIUM					MONO-POLIZIMI ANODA				
SHPEJTUESI I REAKSION-EVE KIMIKE									PËREMËR PRONOR	

Sport

REDAKTOR: Afrim Toverlani
E-MAIL: afrim.toverlani@gazetaexpress.com
TEL: 038 542 270 FAX: 038 542 270-2

Davies vazhdon me Bolton

Sulmuesi i Boltonit, Kevin Davies, ka vazhduar kontratën me klubin deri në verën e vitit 2010. Kontrata e kaluar skadonte në fund të sezonit, por menaxheri i Boltonit, Sam Allardyce ishte gjithmonë optimist se Davies do t'i besojë të ardhmen e tij klubit nga Reebok Stadium. Ai për ueb faqen zyrtare të klubit tha se "Kevin ka rëndësi të madhe në rrugën tonë drejt së ardhmes dhe jam shumë i lumtur që ai ka vazhduar kontratën". Ndërsa Davies tha se "më vjen mirë që gjithçka është rregulluar".

Ferrari nuk lëviz nga Roma

Trajneri i Romës, Luciano Spalletti, ka hedhur poshtë spekulimet se Matteo Ferrari do të përfshihet në shkëmbim me mbrojtësin e Tottenham, Lee Young-Pio. Gjatë javës së kaluar mediat italiane si dhe ato angleze kishin njoftuar se klubet janë duke punuar drejt

shkëmbimit të lojtarëve. Mirëpo, një gjë e tillë është hedhur poshtë nga Spalletti, i cili tha se "nuk e di se çfarë lojtari është Lee dhe as që më intereson. Për sa i përket Ferrarit, ai do të mbetet në Romë. Është duke luajtur mirë".



Cana 120 minuta në fitore



Ekipi i kosovarit Lorik Cana, Marseille, është kualifikuar në të tetën e finales së Kupës së Francës. Marseille e ka mposhtur si mysafir skuadrën e Le Mans me rezultat 1-0. Goli i fitores erdhi vetëm pas lojës shtesë edhe atë

në minutën e 120 nga Mamadou Niang. Ekipi i Le Mans ka mbetur me një lojtar më pak që nga minuta e 43-të, pasi Lucau është ndëshkuar me karton të kuq, por skuadra e kosovarit nuk ka arritur ta shfrytëzojë epërsinë numerike deri në minutën fundit të lojës shtesë. Cana ka luajtur gjatë gjithë takimit.

Bogdani i plotë në humbje



Erjon Bogdani ka luajtur 90 minuta kundër ish skuadrës së tij Sienës, ku kjo e fundit e mposhti Chievon me rezultat 2-1. Të parët në epërsi kaluan mysafirët përmes golit të Brighit në minutën e 25-të, ndërsa në

pjesën e dytë Siena kthen lojën me golat e Antoninit në minutën e 62-të dhe të Portanovas 5 minuta më vonë. Ndeshjen e ardhshme Chievo do ta luajë kundër Empolit si vendas.


Kapllani 89 minuta pa gol



Futbollisti i Kombëtares shqiptare, Edmond Kapllani, ka luajtur 89 minuta në ndeshjen që skuadra e tij e fitoi me rezultat 2-1. Ekipi i Kapllanit, Karlsruher SC, që kryeson në

Bundesligën II, mposhti skuadrën e Burghausenit. Golin e parë e shënoi Federico në minutën e 61-të, ndërsa për epërsinë 2-0 u përkujdes Porcello dy minuta më vonë. E tëra që arritën të bëjnë mysafirët ishte goli i Burkhardt në minutën e 83-të që shënoi rezultatin përfundimtar. Kapllani pati një paraqitje shumë të mirë duke u angazhuar maksimalisht gjë që bëri që ai të duartrokitet nga 21000 tifozët e pranishëm në stadium. Karlsruher SC tani ka 41 pikë të tubuara dhe ka 4 pikë më shumë se përcjellësi Hansa Rostock, që ka një lojë më pak të zhvilluar.

Hetemaj titullar



Mesfushori kosovar i skuadrës athinasë AEK, Përparim Hetemaj, ka qenë titullar në fitoren e skuadrës së tij që e ka shënuar në shtëpi të vetë përballë ekipit Atromitos me rezultat 3:0. Kosovari me pas-

aportë finlandeze ka dalë nga loja në minutën e 57-të për t'ia liru vendin mesfushorit tjetër Vasilios Lakis. Me këtë fitore, skuadra e mesfushorit kosovar zë pozitën e dytë të renditjes tabelore me 40-të pikë të tubuara.

I GATSHËM PËR KOMI

Thotë se ka biseduar me selektorin e Kombëtares shqiptare Otto Bariç nëpërmjet i takohen edhe sy më sy në Frankfurt. Ai është i gatshëm ta pranojë ftesën e Shqipërie me skuadrën e tij Eintracht Frankfurt do të luajë në Bundesligë. Faton Toski fletë pë



Valdet Hasani

PRISHTINË, 21 JANAR — Mesfushori kosovar Faton Toski, është i gatshëm ta pranojë ftesën nga selektori i Kombëtares shqiptare Otto Bariç, për ta veshur fanellën kuq e zi. 19 vjeçari beson se këtë sezon do t'i ndihmojë ekipit të tij Eintracht Frankfurt në Bundesligën gjermane.

Mesfushori gjilanas pohon se ka pasur kontakte me selektorin e Kombëtares shqiptare Otto Bariç. Sipas Faton Toskit, trajneri kroat do të udhëtojë drejt Frankfurtit për t'u takuar edhe sy më sy.

"Kam folur me trajnerin e Shqipërisë Otto Bariç dhe ai është i interesuar që unë të jam pjesë e Kombëtares. Por, ai do të vijë së shpejti këtu në Frankfurt për të biseduar edhe një herë me mua, për t'i precizuar gjërat", u shpreh Toski.

"Çdo herë e kam pasur ëndërruar të luaj për Shqipërinë dhe jam i gatshëm ta vesh fanellën e Kombëtares", shtoi gjilanas.

Toski mendon se ekipi kombëtar i Shqipërisë ka probleme me repartin e mbrojtjes, por edhe me sulmin.

"Kam përcjell shumë ndeshje të Shqipërisë dhe mendoj se

Kombëtarja shqiptare ka probleme me mbrojtjen dhe sulmin", vlerëson ai.

Mesfushori i lindur në Gjiljan ka zhvilluar disa ndeshje në fanellën e përfaqësueses U 19 të Gjermanisë. Sipas rregullores së FIFA-s, kjo nuk do t'i paraqesë problem kosovarit që ta veshë fanellën kuqezi.

Në fillim të sezonit vjeshtor, Toski ishte lënduar dhe si pasojë e kësaj ai nuk pati mundësi të luajë me ekipin e Eintracht Frankfurtit.

Pas pauzës gjashtë muajsh, Toski tash i është rikthyer stërvitjeve dhe beson se këtë sezon do të luajë në Bundesligë.

"Para një jave kam filluar ushtrimet dhe jam duke bërë stërvitje të diferencuara nga ekipi derisa të forcohem mirë", theksoi ai.

"Synimi im është që këtë sezon të luaj me skuadrën time Eintracht Frankfurt dhe besoj se këtë do ta bëj," deklaroi Toski i cili deri në vitin 2009 ka kontratë me ekipin gjerman.

Eintracht Frankfurt sezonin vjeshtor e ka përmbyllur në vendin e dhjetë, me 22 pikë të tubuara.

Bariç lavdëron Toksin

Në një intervistë dhënë Expressit javën e kaluar, Otto Bar-

SHBA mposht Danimarkën

Johathan Bornstein dhe Kenny Copper shënuan derisa Shtetet e Bashkuara të Amerikës u kthyen nga disavantazhi dhe fituan 3-1 të shtunën gjatë një ndeshjeje miqësore kundër Danimarkës. Dennis Sorensen kishte shënuar për epërsinë e Danimarkës para se

Landon Donovan të barazojë rezultatin nga penalltia pak para përfundimit të pjesës së parë. Ky ishte goli i 26-të në paraqitjen e 85 të ndërkombëtare për Donovani, i cili me këtë rast i dha fund serisë prej 18 ndeshjesh pa realizuar për Kombëtaren.

Gerrard kërkohet nga Juventus

Juventus janë duke përgatitur ofertë prej 45 milionë eurosh për mesfushorin e Liverpoolit, Steven Gerrard. Bianconerët planifikojnë të shënojnë rikthimin e tyre në Serie A duke transferuar kapitenin e klubit nga Anfield Road. Drejtori sportiv i Juventusit, Alessio Secco, konfirmoi

të dëlën për News of the World se "Gerrard është lojtar i mirë i cili është ëndërr e jona për një kohë të gjatë". Gerrard dy herë më parë kishte refuzuar Chelsea, duke insistuar se nuk dëshiron të luajë për një tjetër ekip në Premierligë. Italia është një opsion tjetër.



BETARE

telefonit, por pritët të ërisë. Beson se këtë sezon ër Express.



Toski duke dhënë autograme

ic ka deklaruar se Faton Toski është njëri ndër shqiptarët më të talentuar në Evropë.

"Faton Toski në të ardhmen e afërt do të jetë reprezentues i sigurt i Shqipërisë. FSHF-ja duhet që sa më shpejt t'ia rregullojë pasaportën. Fatoni është njëri ndër lojtarët më të talentuar shqiptar në Evropë, por lëndimi ia ka pamundësuar të luajë më tepër në sezonin e kaluar", ka thënë kroati.

"Kam biseduar me Fatonin dhe me trajnerin e tij, i cili më tha se po mos të ishte i lënduar kosovari, ai do të luante gjatë edicionit vjeshtor në ekipin e parë të Eintracht Frankfurt," ka theksuar kroati 74 vjeçar.

Pas skuadrës së Partizanit, edhe Tirana vendos të mos i lëshojë futbollistët në grumbullim. Otto Bariç ka pasur vetëm 12 futbollistë në dispozicion për stërvitjen e parë në Antalia.

Bariç "tradhthohet" nga klubet



Grumbullimi i Kombëtares B në Antalia duket se po shkon gjithnjë e më shumë drejt një dështimi, pasi trajneri Bariç nuk do të ketë në dispozicion një pjesë të konsiderueshme të futbollistëve të përzgjedhur. Pas Partizanit, edhe Tirana ka bojkotuar grumbullimin e kuqezinjve, duke mos pranuar të lërë lojtarët gjatë fazës përgatitore. Meqenëse lojtarët tiranas ishin

sa një e treta e lojtarëve të grumbulluar, tashmë Bariç ka një numër tejet të reduktuar futbollistësh në dispozicion. Vetë trajneri nuk ka dhënë ende asnjë koment, ndonëse është detyruar që të stërvitet me vetëm 12 lojtarë në ditën e parë të stërvitjes.

Nëse mungesa e Muzakës dhe Bakajt të Partizanit nuk kompromente zhvillimin normal të stërvitjes së Kombëtares B në An-

talia, vendimi i djeshëm i Tiranës ka shkatërruar planet e Bariçit. Klubi i Tiranës i ka njoftuar zyrtarisht se nuk do të vë në dispozicion të Bariçit 7 lojtarë që ai kishte planifikuar për të grumbulluar për stërvitje nga radhët e kësaj skuadre, duke preferuar që të vazhdojë fazën përgatitore me kontingjent të plotë. Hidi, Dede, Bulku, Duro, Muka, Sinani dhe Abazaj kanë vazhduar të

qëndrojnë me pjesën tjetër të skuadrës së tyre në Belek, pak kilometra larg "mini-kombëtares" dhe trajnerit kroat, i cili dje ka patur në dispozicion vetëm 12 lojtarë. Grupit të futbollistëve të kampionatit tonë i janë bashkuar edhe një pjesë e lojtarëve që aktivizohen jashtë Shqipërisë si Memelli, Hyka Hasani dhe Neziraj. Aliaj dhe Dedaj do të bashkohen sot me grupin në stërvitje, ndërsa Curri dhe Dallku do të jenë të pranishëm vetëm pas datës 25. Kjo nuk i garanton trajnerit kroat një numër të mjaftueshëm lojtarësh për të zhvilluar miqësore, pasi ka me vete vetëm portierë, mbrojtës dhe sulmues. Ndryshimi i pozicioneve të tyre nuk do ta ndihmonte atë të shihet vlerat reale të futbollistëve dhe si rrjedhojë, të gjitha stërvitjet apo edhe miqësoret janë vënë në dyshim. Sot ishte planifikuar që të zhvillohej një miqësore me Tiranën, por vështirë se do të ndodhë një gjë e tillë, pasi trajneri nuk mund të përballet me bardheblutë me mungesa në formacion dhe pa e pasur mirë idenë se si mund të rreshtojë në fushë lojtarët që ka në dispozicion.

Kryesojnë ekipet e kryeqytetit

Sigal Prishtina dhe AS Prishtina i kanë mbyllur XVIII xhirot e Siguria Superligës të basketbollit në krye të tabelës, me pikë të njëjta. Në vazhdim, Superliga do të ndahet në dy grupe me nga gjashtë skuadra, Superliga A dhe B.

Moral Pozhegu

PRISHTINË, 21 JANAR — Xhiroja e fundit e Siguria Superligës së basketbollit nuk kishte rëndësi të veçantë, pasi që pozitat e skuadrave janë përcaktuar më parë. Dy kryesuesit nga kryeqyteti, Sigal Prishtina dhe AS Prishtina, kanë fituar lehtë ndaj Vëllaznimit përkatësisht Bashkimit.

Trepça ka mbajtur pozitën e tretë pas fitores si vendës ndaj Pejës, kurse Bambi ka mposhtur Dritën si mysafir.

Superliga në dy grupe

Pas përfundimit të xhiros XVIII, respektivisht të kampionatit të rregullt, liga do të ndahet në dy grupe: Superliga A dhe Superliga B. Sipas renditjes së deritashme, Superligën A do ta përbëjnë 6 skuadrat e para, Sigal Prishtina, AS Prishtina, Trepça, Peja, Vëllaznimi dhe Bambi, të cilat do të vazhdojnë me pikët që kanë fituar deri tash.

Pas ndeshjeve vajtje-ardhje, në Superligën A për në "play-off" do të kualifikohen katër skuadrat e para, derisa e pesta dhe e gjashta



do ta presin fillimin e sezonit të ardhshëm.

Ndërsa në Superligën B do të garojnë 6 skuadra të tjera, katër skuadrat e fundit të Siguria Superligës, X Prishtina (i ka lëshuar garat), Kastrioti, Drita, Bashkimi dhe dy skuadrat e para të Pelisterka Ligës (Ligës së Parë), Kosova e Vushtrrisë dhe Ylli i Therandës.

Në Superligën B, 6 skuadrat do t'ia nisin nga e para, pra nga 0 pikë. Edhe në këtë grup do të luhet me sistemin vajtje-ardhje. Skuadrat që do ta mbyllin këtë garë në vendin e pestë dhe të gjashtë, do të bien në një rang më të ulët garash.

Kurse i katërti i Superligës B do të luajë në

"play-out" me skuadrën që do ta zë vendin e parë në Pelisterka Ligë. Tri ekipet e para të Superligës B nuk fitojnë asgjë.

Superliga A do të fillojë më 3-4 shkurt, kurse Superliga B një javë më vonë.

Rezultatet - java XVIII

Sigal Prishtina - Vëllaznimi	114:77
Trepça - Peja	84:70
Drita - Bambi	86:95
Bashkimi - AS Prishtina	55:96
Kastrioti - X Prishtina	

Tabela

1. Sigal Prishtina 33
2. AS Prishtina 33
3. Trepça 32
4. Peja 31
5. Vëllaznimi 26
6. Bambi 26
7. X Prishtina 24 (-1)
8. Kastrioti 22 (-1)
9. Drita 20
10. Bashkimi 19



Kontratë e re për Ronaldo


Sir Alex Ferguson është i gatshëm t'i ofrojë kontratë të re mesfushorit Cristiano Ronaldo. News of the World ka bërë të ditur se menaxheri i Manchester United ka ftuar përfaqësuesit e reprezentuesit portugez për të biseduar rreth kontratës së re pesëvjeçare

me vlerë prej 100 mijë funte në janë. "Manchester United është klub i madh dhe Cristiano me gjasë do të qëndrojë këtu për shumë vite me radhë", tha për News of the World, një burim i afërt me lojtarin, kontrata e së cilit skadon në vitin 2010.

Skandal i ri në Australian Open

Ditë të vështira për organizatorët e Australian Open, meqë skandalet në garën e këtij viti nuk kanë fund. Pas rrahjes me tifozëve kroatë dhe atyre serbë, policia ka arrestuar një mashkull 32 vjeç, i cili me kamerë digjitale në Rod Laver Arena kishte

incizuar pamjet ndër mini-fundet e femrave në tribuna. Dy femra kishin thirrur policinë pasi kanë vërejtur sjelljen e dyshimtë të personit. Policia e kishte kapur atë dhe i kishte konfiskuar kamerën. Atë e pret një gjobë për sjellje të pahijshme.



Petr Cech thotë se me rikthimin në fushë nga lëndimi, ai ka shënuar një fitore të madhe personale. Portieri i Chelseas ende shpreson se ekipi do të arrijë të mbrojë titullin e kampionit. Ndërkohë, drejtori ekzekutiv Peter Kenyon, mohon mosmarrëveshjet mes pronarit Roman Abramovich dhe menaxherit Jose Mourinho.

RIKTHIMI ESHTË FITORE

Portieri i Chelseas, Petr Cech, ka përshkruar pritjen e gjatë për rikthim në fushë si "një fitore të madhe personale". Reprezentuesi i Republikës Çeke u paraqit në ndeshjen e tij të parë pas afro tre muajve në disfatën e Chelseas të shtunën 2-0 nga Liverpool, ku shënoi rikthimin nga lëndimi në kokë që pësoi pas një përplasjeje me sulmuesin e Reading, Stephen Hunt. Cech është i detyruar të mbajë një helm të mbrotjes në kokë për pjesën e mbetur të sezonit pasi ka pësuar një lëndim të rrezikshëm për jetë. Mirëpo, portier i klubit nga Stamford Bridge pranon se ishte i lumtur që ka lënë lëndimin pas vetes pavarësisht se

Chelsea u mposht në Anfield. "Fakti se kam luajtur kundër Liverpool është një fitore e madhe personale", tha Cech të dielën për ueb faqen zyrtare të Chelseas. "Disfata sado pak e prish këtë gëzim, por prapë jam i lumtur që nuk kam bërë ndonjë gabim gjatë ndeshjes. Jam ndjerë shumë mirë gjatë takimit. Nuk ishte e lehtë pas golit të parë, mirëpo jam ndihmuar pasi prita goditjen e John Arne Risse", shtoi ai. Cech mendon se Chelsea pavarësisht nga disfata e pësuar nga Liverpool, do të vazhdojë të luftojë për titullin e kampionit në Premierligë. "Nuk mendoj se kjo ndeshje ka qenë vendimtare për titull. Kanë mbetur edhe shumë takime për të zhvilluar deri në fund të sezonit. Mendoj se Manchester United do ta ketë mjaft vështirë të vazhdojë në këtë ritëm. Ne do të përmirësohemi dhe shpresoj se do të kthehemi në krye", deklaroi ai. Ndërkohë, drejtori ekzekutiv i Chelseas, Peter Kenyon, ka mohuar sugjerimet rreth mosmarrëvesh-

jeve mes pronarit Roman Abramovich dhe menaxherit Jose Mourinho. Strategu portugez spekulohet se në fund të sezonit do të largohet nga klubi, por Kenyon tha të dielën për BBC Five Sport se "pronari dhe bordi kanë përkrahje të plotë ndaj Mourinhos. Po ashtu Jose javën e kaluar ka deklaruar se adhuron Chelsea dhe se është i lumtur me jetën në Londër. Ai me klubin ka kontratë deri në vitin 2010 dhe synon ta respektojë atë". Menjëherë pas disfatës nga Liverpool, në mediat angleze pati njoftime se Mourinho definitivisht ka vendosur të largohet në fund të sezonit, por Kenyon është shprehur se "është e çuditshme që menjëherë pas humbjes janë kthyer prapë këto njoftime. Mirëpo, te Chelsea gjithçka është në rregull. Marrëdhëniet mes menaxherit, pronarit, drejtorit ekzekutiv dhe bordit nuk kanë ndryshuar dhe nuk do të ndryshojnë kurrë. Për të qenë të suksesshëm, duhet të kemi një ekip të bashkuar".

Larsson synon të vazhdojë qëndrimin

■ Henrik Larsson ka bërë të ditur se do të dëshiron të qëndrojë në Manchester United deri në fund të sezonit. Periudha e huazimit të sulmuesit holandez në Old Trafford do të përfundojë më 12 mars, kur ai pritet të kthehet në Helsingborg për fillimin e Kampionatit suedez. Megjithatë, menaxheri i Manchester United, Sir Alex Ferguson, besohet se dëshiron të mbajë Larssonin sa më gjatë të jetë e mundshme pas paraqitjeve të mira të treguara deri më tani me Djajtë e Kuq. Edhe Larsson insiston se do të ishte i lumtur të vazhdojë qëndrimin në Manchester United, gjithnjë nëse me këtë pajtohesh edhe Helsingborg. "Kam ardhur t'i ndihmoj Manchester

United aq sa mundem deri në muajin mars. Sigurisht se do të dëshiroja të qëndroja deri në fund të sezonit, por kjo varet edhe nga Helsingborg, andaj aty nuk mund të ndërhyj", tha Larsson. Helsingborg fillimisht kishte thënë se "nuk do të qëndrojë në rrugë të Larssonit" nëse ai kërkon të mbetet në Old Trafford. Megjithatë, javën e kaluar zyrtarët e klubit suedez kanë ndryshuar mendjen dhe kanë thënë se nuk ka mundësi që huazimi i Larssonit të zgjatet deri në fund të sezonit në Premierligë.



Prëzohet Mauresmo

■ Kampionia e turneut të edicionit të kaluar në konkurrencën e femrave, Amelie Mauresmo, është eliminuar në rrethin e katërt të Australian Open nga Lucie Safarova. Në çerekfinale kaloi Serena Williams. Te meshkujt, Roger Federer nuk pati punë të vështirë para Novak Djokovic, derisa Andy Rodick pas pesë seteve arriti të mposhtë kroatin Mario Ančić.



Konkurrenca e meshkujve - Rrethi i katërt

Roger Federer - Novak Djokovic 6-2 7-5 6-3
Tommy Robredo - Richard Gasquet 6-4 6-2 3-6 6-4
Andy Roddick - Mario Ancic 6-3 3-6 6-1 5-7 6-4
Mardy Fish - David Ferrer 6-1 7-6 2-6 7-5

Rrethi i tretë

Tommy Haas - Florian Mayer 7-6 6-3 6-3
Tomas Berdych - Dmitry Tursunov 6-2 6-1 6-1

Konkurrenca e femrave - Rrethi i katërt

Serena Williams - Jelena Jankovic 6-3 6-2
Nicole Vaidisova - Elena Dementieva 6-3 6-3
Shahar Peer - Svetlana Kuznetsova 6-4 6-2
Lucie Safarova - Amelie Mauresmo 6-4 6-3

Rrethi i tretë

Daniela Hantuchova - Ashley Harkleroad 6-7 7-5 6-3
Anna Chakvetadze - Jelena Kostanic 6-4 6-4

Një vjet pa Presidentin historik të Kosovës



Dr. Ibrahim Rugova

Jemi krenarë që patëm nderin të punojmë me Ju, Presidenti ynë i dashur, dr. Ibrahim Rugova.

Shërbimi Civil i Zyrës së Presidentit të Kosovës